



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
DREJTORIA E SHËRBIMIT SOCIAL

Nr 4111 Prot

Elbasan më 19/08/2025

RELACION

Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i Bashkisë për muajin KORRIK 2025

KËSHILLIT BASHKIAK

Mbështetur në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, si dhe bazuar në kriteret e VKB nr 23 datë 04.03.2025 “Mbi miratimin e kriterëve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i Bashkisë”

Propozojmë:

1. Të trajtohen me ndihmë ekonomike nga fondi i të ardhurave të Bashkisë për muajin KORRIK 2025 gjithsej 75 familje me një fond gjithsej 230.000 lekë .
Këto janë familje shumë të varfëra të cilat nuk kanë mundësi të aplikojnë në sistemin e ndihmës ekonomike pasi për shkaqe të ndryshme sociale, shëndetësore dhe ekonomike, një anëtar madhor nuk është prezent gjatë aplikimit .
Këto janë raste të grave të braktisura nga bashkëshortët e tyre dhe anasjelltas, familje të cilat kanë në përbërje të tyre anëtarë madhorë me probleme të shëndetit mendor të cilët largohen nga banesa pa adresë fikse, familje që kanë në përbërje të tyre anëtarë madhorë me probleme të ndryshme sociale (alkooli, droga etj) të cilët nuk janë në gjendje të paraqiten në ditën e aplikimit të ndihmës ekonomike në sistem.
2. Masa e pagesës për të gjitha familjet përfituese të jetë konform V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike” paragrafi IV pika 11.

Konceptoi: M.Duka
Pranoi: D.Shuli
Konfirmoi: D.Roseni

Zv/Kryetari

Armand Shehu





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK ELBASAN

Nr. _____ Prot

Elbasan më ____/08/ 2025

PROJEKT - VENDIM

Nr. ____ datë ____/08/ 2025

Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i Bashkisë për muajin KORRIK 2025

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës ____/08/2025 pasi shqyrtoi materialin e paraqitur nga DSHKSK, bazuar në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, si dhe bazuar në kriteret e VKB nr 23 datë 04.03.2025 “Mbi miratimin e kriterëve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i Bashkisë”

VENDOSI

1. Të miratojë dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i të ardhurave të Bashkisë për muajin KORRIK 2025 për 75 familje me një fond prej 230.000 lekë.
2. Masa e pagesës për të gjitha familjet përfituese të jetë konform V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike” paragrafi IV pika 11.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimit Social dhe Drejtoria e Financës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Dr Shërbimeve Sociale
Drejtori Juridik

D.Shuli
A.Hoxha

Drejtori Finance-Buxhet

A. Merkja

Sekretar i Këshillit Bashkiak
Sokol Sinani

Kryetari i Këshillit Bashkiak
Lutfi Lala

FK. 2



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
DREJTORIA E SHËRBITIMIT SOCIAL

Nr. Prot 4110

Elbasan më 19/08/2025

RELACION

**Mbi dhënien e Ndhmës Ekonomike nga fondi i Kushtëzuar për muajin KORRIK 2025
KËSHILLIT BASHKIAK**

Mbështetur në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, nenin 21 të ligjit nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, si dhe bazuar në kriteret e VKB nr. 24 datë 04.03.2025 “Mbi miratimin e kriterëve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike”, paraqesim për miratim propozimin e familjeve që do trajtohen nga fondi i kushtëzuar.

**I. Të trajtohen me ndihmë ekonomike nga fondi i Kushtëzuar për muajin KORRIK 2025 ,
253 familje me një fond prej 1.214.411 lekë.**

Këto janë familje të varfra të cilat kanë aplikuar në sistemin e ndihmës ekonomike dhe për shkak se nuk kanë marrë pikët e mjaftueshme, nuk janë kualifikuar përfitues të ndihmës ekonomike nga sistemi i pikëzimit.

Këto janë kryesisht familje me një ose dy antarë. Pra këtu kemi familje të cilat janë me një anëtarë, si femrat ose meshkujt në moshë të madhe të pamartuar ose të divorcuar, të cilët kanë ose jo një ose dy fëmijë në ngarkim ; personat mbi moshë pune të cilët nuk kanë përfituar pension pleqërie .

Masa e pagesës për të gjitha familjet përfituese të jetë konform V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike” paragrafi IV pika 11.

Konceptoi: M.Duka
Pranoi: D.Shuli
Miratoi: D.Roseni

ZV/KRYETARI
ARMAND SHEHU



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK ELBASAN

Nr. _____ Prot

Elbasan më ____/08/ 2025

PROJEKT – VENDIM

Nr. ____ datë ____/08/2025

Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin KORRIK 2025

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës ____08/2025 pasi shqyrtoi materialin e paraqitur nga DPPSSSHKI, bazuar në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, nenin 21 të ligjit nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë” V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, si dhe bazuar në kriteret e VKB nr. 24 datë 04.03.2025 “Mbi miratimin e kriterëve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike”

VENDOSI

1. Të miratojë dhënien e ndihmës ekonomike nga fondet e kushtëzuara për muajin KORRIK 2025 për 253 familje me një fond prej **1.214.411** lekë.
2. Masa e pagesës për të gjitha familjet përfituese të jetë konform V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike” paragrafi IV pika 11.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimit Social dhe Drejtoria e Financës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Drejtori Shërbimit Social D.Shuli

Drejtori Juridik

A.Hoxha

Drejtori Finance-Buxhet

A. Merkja

Sekretar i Këshillit Bashkiak

Sokol Sinani

Kryetar i Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



BASHKIA ELBASAN
DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIAL
SEKTORI I VLERËSIMIT DHE PAGESAVE TË NDIHMËS EKONOMIKE
DHE AFTËSISË SË KUFIZUAR

INFORMACION KRAHASUES PËR NDIHMËN EKONOMIKE PËR MUAJIN
KORRIK 2025

I. Ndhimja ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin KORRIK 2025

Korrik	253 familje	fondi	1.214.411
Qershor	241 familje	fondi	1.168.635

Për muajin Korrik 2025 kemi 12 familje më shumë se muaji paraardhës që propozojmë të trajtohen me ndihmë ekonomike nga fondi I kushtëzuar.

Fondi i shpenzuar është 45.776 lekë më shumë se muaji paraardhës.

Familjet e larguara nga ndihma ekonomike nga fondi I kushtëzuar janë:

- | | |
|----------------------|---------------------|
| 1. Blegina Bezhani | (aplikon në sistem) |
| 2. Kadife Toromani | (aplikon në sistem) |
| 3. Kadime Ballhysa | (aplikon në sistem) |
| 4. Myftar Biçaku | (aplikon ne sistem) |
| 5. Petrit Lloshi | (aplikon ne sistem) |
| 6. Qemal Bajrami | (aplikon ne sistem) |
| 7. Agim Llapushi | (aplikon ne sisem) |
| 8. Merita Kondakçi | (aplikon ne sisem) |
| 9. Ermela Limanllari | (aplikon ne sisem) |
| 10. Melisa Staka | (emigracion) |

II. Ndhimja ekonomike nga fondi i Bashkisë për muajin Korrik 2025

Korrik	75 familje	fondi	230.000
Qershor	79 familje	fondi	235.000

Për muajin Korrik 2025 kemi 4 familje më pak se muaji paraardhës që propozojmë të trajtohen me ndihmë ekonomike nga fondi i Bashkisë.

Fondi është 5.000 lekë më pak se muaji paraardhës.

Familjet e larguara nga ndihma ekonomike nga fondi I Bashkisë janë :

- | | |
|---------------------|-----------------------|
| 1. Bashkim Isufi | (aplikon ne sistem) |
| 2. Flamur Kyçyku | (nuk paraqitet) |
| 3. Hasan Lushnjani | (aplikon ne sistem) |
| 4. Mariglen Zdrava | (aplikon ne sistem) |
| 5. Silvana Mehja | (perfitues në sistem) |
| 6. Sajmir Noni | (aplikon ne sistem) |
| 7. Thëllëza Muzhaqi | (emigracion) |

Konceptoi

Specialiste Ermira Dika



Përgjegjëse Sektori

Miranda Duka



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
DREJTORIA E MONITORIMIT
SEKTORI I STATISTIKAVE MENAXHIMI I MONITORIMIT TË PERFORMANCËS

Nr. 4099 prot.

Elbasan, më 18.08.2025

RELACION
PER
PROJEKT VENDIMIT

“PËR
MIRATIMIN E PROJEKTMARRËVESHJES PËR KRIJIMIN E PERSONIT JURIDIK SI
SUBJEKT I KOMPETENCAVE TË PËRBASHKËTA MIDIS NJËSIVE TË
VETËQEVERISJES VENDORE DHE KËSHILLIT TË MINISTRAVE PËR RRITJEN E
KAPACITETEVE TË QEVERISJES VENDORE, AKADEMIA E TRAJNIMIT TË NJËSIVE
TË VETËQEVERISJES VENDORE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË (TALGA)”

Të nderuar Këshilltarë !

I. Qëllimi i projekt vendimit dhe objektivat që synohen të arrihen

Ligji nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” ka përcaktuar funksionet e NJVV-ve dhe të drejtën dhe detyrimin për trajnimin e zyrtarëve (punonjësit dhe të zgjedhurit vendorë) në mënyrë që ato të ushtrjnë këto funksione sipas ligjit, standarteve, me efektivitet, efikasitet dhe në përputhje me strategjitë dhe prioritetet kombëtare, si dhe me standardet e BE-së. Në ligj parashikohet trajnim sistematik dhe buxhetor i stafit të NJVV-ve. Në këtë kuadër, kryetari i bashkisë duhet të marrë masa për kualifikimin dhe trajnimin e personelit të administratës, të institucioneve arsimore, sociale, kulturore e sportive (Neni 64/h), ndërkohë këshilltarët kanë të drejtën e formimit profesional, sipas një programi të miratuar nga këshilli bashkiak (Neni 51/4).

Ky projekt vendim ka si qëllim mundësimin e zhvillimit dhe kualifikimit profesional të qëndrueshëm të të zgjedhurve, nëpunësve civilë dhe punonjësve të tjerë të bashkisë.

Ky projekt vendim ka si objektiva:

- Krijimin e mundësive për ushtimin e përgjegjësive ligjore të këshillit bashkiak dhe të kryetarit të bashkisë për zhvillimin dhe kualifikimin profesional të qëndrueshëm të të zgjedhurve, nëpunësve civilë dhe punonjësve të tjerë të këshillit të qarkut.
- Zbatimin e Strategjisë Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2023-2030.
- Zbatimin e Dokumentit Kombëtar të Politikave dhe të Strategjisë për Administratën Publike.
- Aftësimin e zyrtarëve të bashkisë për të përballuar sfidat dhe kërkesat e procesit të integritetit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian.
- Krijimi i një strukture të dedikuar për aftësimin, kualifikimin profesional dhe trajnimin e zyrtarëve të bashkisë.

Nga pikëpamja organizimit dhe funksionimit, projektvendimi krijon premisat e nevojshme ligjore për krijimin e një personi juridik si subjekt të kompetencave të përbashkëta (SPK) në përputhje me parashikimet e Ligjit nr.139/2015, neni 14 pika 5. Kështu, dy ose më shumë njësi të vetëqeverisjes vendore, brenda një qarku apo midis qarqeve të ndryshme, si dhe me institucione të qeverisjes qendrore, mund të lidhin marrëveshje të përbashkët për krijimin e një personi juridik të ndarë nga palët, të cilit i japin autoritet dhe kompetenca të caktuara. Në kuptimin e këtij ligji, ky person juridik quhet subjekt i kompetencave të përbashkëta. Palët përcaktojnë ndihmesa financiare, ndihmesa me shërbime, ndihmesa me pajisje dhe me punonjës të kualifikuar ose çdo aset tjetër i nevojshëm për përmbushjen e objektivave të SKP.

Ligji parashikon të drejtën për të krijuar person juridik dhe në linjë me parashikimet e Kodit Civil (nenet 24 dhe 26), personi juridik mund të jetë edhe shoqëri, shoqatë, fondacion dhe ent me karakter privat, të cilat e fitojnë personalitetin juridik në mënyrën e caktuar nga ligji.

Nisur nga fakti që në këtë subjekt të kompetencave të përbashkëta angazhohen të ndërliken dhe ndërveprojnë nivele të ndryshme të qeverisjes (qendrore dhe vendore), propozohet të krijohet një Organizatë Jo-Fitimprurëse (OJF) në përputhje me Ligjin nr.8788/2001 “Për organizimin dhe funksionimin e OJF-ve”, ndryshuar. Ky opsion ka të njëjtën referencë ligjore si modeli i SHA-ve të Ujësjellës-Kanalizimeve, dhe ofron pavarësi në vendimmarrje dhe financim.

Kjo bazë ligjore mundëson krijimin e një OJF-je që garanton pavarësinë qeverisëse, funksionale, financiare dhe akademike, si dhe siguron qëndrueshmërinë afatgjatë të saj, lejon fleksibilitet në mbledhjen dhe menaxhimin e fondeve nga burime të ndryshme përfshirë donatorët, ndërkohë që garanton përfshirje të barabartë të aktorëve të qeverisë qendrore dhe atyre vendore në qeverisjen, politikëbërjen, vendimmarrjen dhe financimin e saj.

II. Vlerësimi i projekt aktit në raport me politikat dhe prioritet e bashkisë dhe të Qeverisë së Shqipërisë.

Vetëqeverisja vendore është shtyllë themelore e funksionimit të një shoqërie demokratike dhe e zhvillimit ekonomik e shoqëror të vendit, dhe garanton qeverisje të efektshme, efikase dhe në një nivel sa më afër me qytetarët. Suksesi i procesit të decentralizimit dhe i ushtrimit të autonomisë vendore varet, ndër të tjera, edhe nga cilësia e hartimit, zbatimit dhe moniorimit të politikave të bashkisë, cilësia e shërbimeve të ofruara nga bashkia dhe aftësia e bashkisë për t'ju përgjigjur cilësisht nevojave dhe tendencave zhvillimore në nivel vendor, varen në një masë të madhe nga njohuritë, aftësitë, sjelljet dhe profesionalizimi i të zgjedhurive vendorë, i nëpunësve publikë të administratës së bashkisë si dhe i punonjësve të institucioneve, enteve dhe ndërmarrjeve në varësi të bashkisë.

Vetëqeverisja vendore në Shqipëri përballlet me sfida të konsiderueshme në menaxhimin efektiv të burimeve, hartimin dhe zbatimin e politikave për zhvillimin e qëndrueshëm të territoreve dhe komuniteteve, si dhe ofrimin e shërbimeve cilësore për qytetarët. Procesi i decentralizimit të funksioneve tek bashkitë si dhe rritja e kërkesave për shërbime nga qytetarët dhe komunitetet e bëjnë të domosdoshme rifreskimin, përmirësimin dhe avancimin e njohurive dhe aftësive të zyrtarëve vendorë. Gjithashtu edhe politikat kombëtare për të modernizuar administratën publike si dhe për të digjitalizuar qeverisjen dhe shërbimet administrative, bëjnë të domosdoshme kualifikimin, profesionalizimin dhe modernizimin e administratës publike të NJVV-ve.

Trajnimet për zyrtarët e NJVV-ve janë ofruar nga subjekte të ndryshme shtetërore dhe në një masë të madhe nga programet e huaja të asistencës teknike, por këto trajnime kanë qenë sporadike, nuk kanë qenë të qëndrueshme dhe në përputhje me nevojat konkrete të NJVV-ve. Trajnimet nuk janë ofruar për të gjitha funksionet e NJVV-ve, dhe për më tepër kanë lënë shpesh jashtë vëmendjes të zgjedhurit vendorë dhe punonjësit jo-nëpunës civil të NJVV-ve. Trajnimet janë fokusuar kryesisht në përmbushjen e nevojave të përgjithshme horizontale, duke mos adresuar në mënyrë të gjerë dhe të thelluar temat vertikale që lidhen me funksionet dhe shërbimet specifike sektoriale të qeverisjes vendore. Për më tepër, nuk ka ekzistuar ndonjë proces i institucionalizuar dhe i rregullt konsultimi me zyrtarët e NJVV-ve për identifikimin e nevojave për trajnime apo për përmbajtjen e kurrikulave të trajnimit, veçanërisht ato sektoriale.

ASPA dhe institucione të tjera shtetërore kanë ofruar një grup shërbimesh trajnimi për NJVV-të sipas parashikimeve ligjore, por ato mbeten të pamjaftueshme përkundrejt sfidave që NJVV-të përballen dhe pritjet që të përballen në kuadër të procesit të integritimit në BE.

Për pasojë, NJVV-të nuk kanë arritur të plotësojnë nevojat specifike të punonjësve të tyre, duke krijuar një hendek të madh në përmbushjen e kërkesave për trajnim dhe kjo ka sjell në pah nevojën për një qasje më strategjike dhe të integruar dhe një strukturë të qëndrueshme për zhvillimin e kapaciteteve dhe

kualifikimin profesional të zyrtarëve të NJVV-ve, në mënyrë që ato të përmbushin kërkesat në rritje për shërbime cilësore të vetëqeverisjes vendore.

Numri i zyrtarëve të NJVV-ve ka ardhur në rritje, nga rreth 21,442 (2015), në rreth 32,000 (2021), 37,518 (2022), dhe rreth 39,000 (2023), ku të zgjedhurit vendorë dhe punonjësit jashtë shërbimit civil përbëjnë shumicën e zyrtarëve të NJVV-ve, rreth 85% (*White Paper për Akademinë-2024*). Pavarësisht rritjes së numrit të zyrtarëve të NJVV-ve, mbështetja financiare e NJVV-ve për trajnimet e tyre mbetet e ulët.

Por ndërkohë që numri i zyrtarëve të NJVV-ve dhe nevoja e tyre për trajnim ka ardhur në rritje, asnjë strukturë nuk ka pasur mandatin apo kapacitetin për të trajnuar në mënyrë të plotë, praktike dhe në kohën e duhur të zgjedhurit vendorë, nëpunësit civil dhe punonjësit e institucioneve e ndërmarrjeve në varësinë e NJVV-ve.

III. Koncepti, procesi, aktorët dhe modalitetet për ngritjen e Akademisë për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore.

Ngritja e Akademisë për Qeverisjen Vendore, si një strukturë të dedikuar për trajnim e zyrtarëve të NJVV-ve, përfaqëson realizimin e një nisme të kahershme dhe një kërkesë të artikuluar e lobuar prej vitesh nga NJVV-të, me synimin për të përmbushur nevojat e mëdha dhe në rritje për aftësimin dhe kualifikimin e të gjithë zyrtarëve të tyre.

Vizioni për të ngritur një strukturë të dedikuar për trajnimin e zyrtarëve të NJVV-ve u materializua në Strategjinë Ndërsektoriale për Decentralizimi dhe Qeverisjen Vendore 2023-2030 miratuar me VKM nr. 252, datë 20.4.2023, dhe u mbështet nga grupi ndër-institucional të punës të ngritur me urdhër të Kryeministrit (Janar 2023), dhe në takimet e të cilit morën pjesë morën pjesë aktive edhe shoqatat e NJVV-ve. Procesi i diznejimit të Akademisë u mbështet me ekspertizë të huaj dhe vendase, të financuar nga Qeveria Svicere dhe Qeveria Suedeze, u realizua në konsultim me kryetarë të bashkive dhe të këshillave bashkiakë të spektrit të ndryshëm politik si dhe me kryetarë të këshillave të qarqeve. Procesi i diznejimit të Akademisë u realizua me përfshirjen e zyrës së Këshillit të Evropës në Tiranë dhe me praninë e zyrës së Komisionit Evropian në Tiranë dhe të donatorëve të tjerë. Për dizenjimin e Akademisë u morën parasysh 10 modele të shkollave dhe qendrave të trajnimit për administratën publike në Evropë dhe në rajon, si dhe modele të qendrave të trajnimit në Shqipëri. Ndërkohë, me shkresën nr. 532 prot., datë 18.09.2024 Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore (AMVV) ju drejtua 61 kryetarëve të bashkive, duke kërkuar konfirmimin për përfshirjen në buxhetin e vitit 2025 të kontributit financiar të secilës bashki për të mbështetur trajnimet e zyrtarëve të tyre përmes një strukture të dedikura dhe në bazë të numrit të punonjësve të tyre.

Nga ana e NJVV-ve dhe në funksion të realizimit të iniciativës për ngritjen e Akademisë, Asambleja e Përgjithshme e Shoqatës së Bashkive, me vendimin e saj të datës 04.09.2024, dakortësoi angazhimin e

bashkive të Shqipërisë për mbështetjen e kësaj iniciative, si dhe për bashkëfinancimin e Akademisë në vlerën 50% të shpenzimeve operacionale dhe të trajnimeve.

Në vijim të këtyre iniciativave, Grupi Ndër-institucional i Punës miratoi Dokumentin e Politikës (White Paper) për Akademinë (Shtator 2024), dokument që më pas u miratua nga Këshilli Konsultativ Qeveri Qendrore - Qeveri Vendore (Dhjetor 2024).

Në përgjigje të angazhimit të Qeverisë së Shqipërisë për të mbështetur ngritjen e Akademisë si dhe të mbështetjeje së shoqatave të NJVV-ve për ngritjen e Akademisë, këshillat bashkiakë konfirmuan njëzëri mbështetjen e tyre për nevojën e ngritjes së Akademisë, përmes miratimit të një fondi për trajnimet e zyrtarëve të bashkisë e që do t'i vihej në dispozicion Akademisë në momentin e regjistrimit të saj. Ky angazhim financiar përbën një shprehje e vullnetit të fortë të bashkive për ngritjen dhe financimin e Akademisë, si dhe përbën një element të rëndësishëm për avancimin e procesit të ngritjes së subjektit të kompetencave të përbashkëta (SKP).

Edhe Këshilli Bashkiak Elbasan me Vendimin Nr, 138 datë 26.12.2024 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 si dhe të Programit Buxhetor Afatmesëm 2025–2027”, miratoi fondin që do i vihej në dispozicion Akademisë.

Akademia që propozohet të ngrihet si personi juridik subjekt i kompetencave të përbashkëta, do të ofrojë një gamë të gjerë shërbimesh për të mbështetur dhe përmirësuar kapacitetet e NJVV-ve në Shqipëri duke përfshirë hartimin e kurrikulave dhe ofrimin e trajnimeve të specializuara, administrimin e platformës për menaxhimin dhe ndarjen e njohurive mes zyrtarëve të NJVV-ve, rrjetëzimin dhe bashkëpunimin mes tyre, ofrimi i ekspertizës dhe shërbimeve të konsulencës ndaj NJVV-të për zgjidhjen e problemeve dhe arritjen e objektivave në lidhje me zhvillimin e burimeve të tyre njerëzore.

Ngritja e Akademisë është thelbësore për t'i mundësuar NJVV-ve përballimin e sfidave për rritjen e cilësisë së jetës, zhvillim të qëndrueshëm të territorit dhe komuniteteve vendore si dhe sfidave që po sjell procesi i integritetit të Shqipërisë në BE. Vlerësohet se 70% e *acquis* zbatohet nga qeveritë vendore dhe rajonale dhe NJVV-të do të kenë një rol të rëndësishëm në këtë proces, dhe kjo është arsyeja pse niveli i njohurive dhe aftësive të zyrtarëve të NJVV-ve, për të përballuar këto procese, merr një rëndësi të veçantë.

Synohet që ofrimi i trajnimeve të përfshijnë tema specifike dhe sektoriale “vertikale” që lidhen me funksionet e NJVV-ve dhe me rreth 41 shërbimet e vetëqeverisjes vendore të tilla si Zhvillimi i Territorit, Infrastruktura dhe Shërbimet Publike, Shërbimet Sociale; Mbrojtja e Mjedisit; Bujqësia; Zhvillimi Rural; Pyjet dhe Kullotat Publike; Zhvillimi Ekonomik Vendor, Siguria Publike, etj. Programet e trajnimit do të hartohen bazuar në vlerësimin e nevojave për trajnim, do të jenë paktike dhe dinamike, ndërkohë që hartimi i kurrikulave dhe dhënja e trajnimeve do të koordinohet me ASPA për të evituar mbivendosje të trajnimeve të ofruara.

Përfituesit kryesorë të shërbimeve janë nëpunësit civilë dhe punonjësit e institucioneve dhe ndërmarrjeve në varësi të NJVV-ve, si dhe të zgjedhurit vendorë, që përbëjnë rreth 39,000 persona. Kjo përfshirje e gjerë ndihmon në përmirësimin e performancës së qeverisjes vendore dhe në rritjen e cilësisë së shërbimeve për qytetarët.

Nga pikëpamja organizimit dhe funksionimit, projektvendimi krijon premisat e nevojshme ligjore për krijimin e një personi juridik si subjekt të kompetencave të përbashkëta në përputhje me parashikimet e Ligjit nr.139/2015, neni 14 (5). Kështu, dy ose më shumë njësi të vetëqeverisjes vendore, brenda një qarku apo midis qarqeve të ndryshme, si dhe me institucione të qeverisjes qendrore, mund të lidhin marrëveshje të përbashkët për krijimin e një personi juridik të ndarë nga palët, të cilit i japin autoritet dhe kompetenca të caktuara. Në kuptimin e këtij ligji, ky person juridik quhet subjekt i kompetencave të përbashkëta. Për secilën palë përcaktohet ndihmesa financiare, ndihmesa me shërbime, ndihmesa me pajisje dhe me punonjës të kualifikuar ose çdo aset tjetër i nevojshëm për përmbushjen e objektivave.

Ligji parashikon të drejtën për të krijuar person juridik dhe në linjë me parashikimet e Kodit Civil (nenet 24 dhe 26), personi juridik mund të jetë edhe shoqëri, shoqatë, fondacion dhe ent me karakter privat, të cilat e fitojnë personalitetin juridik në mënyrën e caktuar nga ligji.

Nisur nga fakti që në këtë subjekt të kompetencave të përbashkëta angazhohen të ndërlidhen dhe ndërveprojnë nivele të ndryshme të qeverisjes (qendrore dhe vendore), propozohet të krijohet një Organizatë Jo-Fitimprurëse (OJF) në përputhje me Ligjin nr.8788/2001 “Për organizimin dhe funksionimin e OJF-ve”, ndryshuar. Ky opsion ka të njëjtën referencë ligjore si modeli i SHA-ve të Ujësjellës-Kanalizimeve, dhe ofron pavarësi në vendimmarrje dhe financim.

Kjo bazë ligjore mundëson krijimin e një OJF-je që garanton pavarësinë qeverisëse, funksionale, financiare dhe akademike, si dhe siguron qëndrueshmërinë afatgjatë të saj, lejon fleksibilitet në mbledhjen dhe menaxhimin e fondeve nga burime të ndryshme përfshirë donatorët, ndërkohë që garanton përfshirje të barabartë të aktorëve të qeverisë qendrore dhe atyre vendore në qeverisjen, politikëbërjen, vendimmarrjen dhe financimin e saj.

Staregjia decentralizimit

Themelimi i OJF-së si subjekt i kompetencave të përbashkëta midis qeverisjes qendrore dhe NJVV-ve, përmes aktit themelues dhe statutit, kërkon në të njëjtën kohë miratimin nga të gjithë këshillat bashkiakë dhe këshillat e qarqeve të marrëveshjes për anëtarësimin në Akademi, SKP në formë OJF-je, si dhe nënshkrimin e kësaj marrëveshje nga ministri përgjegjës për çështjet vendore sipas autorizimit të dhënë nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë përmes VKM 405 dt.16.07.2025 “*Për autorizimin e ministrit përgjegjës për çështjet vendore për negociimin dhe nënshkrimin e marrëveshjes me njësitë e vetëqeverisjes vendore për krijimin e personit juridik si subjekt i kompetencave të përbashkëta me njësitë e vetëqeverisjes vendore për rritjen e kapaciteteve të qeverisjes vendore të republikës së shqipërisë*”. Sipas këtij vendimi, Këshilli i Ministrave ka marrë angazhimin të mbështesë financiarisht

Akademine përmes mbulimit të kostove fillestare të themelimit të saj si subjekt i kompetencave të përbashkëta, si dhe të financojë jo më pak se 50% të kostove operacionale të funksionimit të Akademisë për tri vitet e para të funksionimit për përmbushjen e objektivave të saj.

Hapi vijues në këtë proces është miratimi i marrëveshjes nga këshillat bashkiakë dhe këshillat e qarqeve përkatëse, në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 139/2015, i ndryshuar. Pas përfundimit të këtij procesi të miratimit, do të vijohet me regjistrimin e personit juridik në Gjykatën e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 8788/2001, "Për organizimin dhe funksionimin e OJF-ve", të ndryshuar.

IV. Propozimi për ngritjen e Akademisë për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore.

Për sa më sipër, dhe në mbështetje të nenit 2, pika 11, nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja "b" dhe nënpika 1.6, shkronja "b", nenit 14 pika 5, nenit 54, shkronja "d" dhe "gj", nenit 55, pikat 3, të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" (i ndryshuar), Ligjit Nr. 8548, datë 11.11.1999 "Për ratifikimin e Kartës Evropiane të Autonomisë Vendore", Ligjit nr. 8788, datë 07.05.2001 "Për organizatat jofitimprurëse" (i ndryshuar), Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 405, datë 16.07.2025 "Për autorizimin e ministrit përgjegjës për çështjet vendore për negocimin dhe nënshkrimin e marrëveshjes me njësitë e vetëqeverisjes vendore për krijimin e personit juridik si subjekt i kompetencave të përbashkëta me njësitë e vetëqeverisjes vendore, për rritjen e kapaciteteve të qeverisjes vendore të Republikës së Shqipërisë", i propozojmë Këshillit Bashkiak si më poshtë vijon:

1. Të miratojë marrëveshjen për krijimin e personit juridik si subjekt i kompetencave të përbashkëta (SKP), në formën e organizatë jofitimprurëse me anëtarësi, midis njësive të vetëqeverisjes vendore të Republikës së Shqipërisë dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për rritjen e kapaciteteve të qeverisjes vendore të Republikës së Shqipërisë, bazuar në statutin dhe aktin e themelimit bashkëlidhur këtij vendimi, të quajtur "Akademia e Trajnimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore të Republikës së Shqipërisë (TALGA)".

TALGA do të ketë si mision zhvillimin dhe kualifikimin profesional të qëndrueshëm të zgjedhurve, nëpunësve civilë dhe punonjësve të tjerë të njësive të vetëqeverisjes vendore, përfshirë punonjësit e institucioneve dhe ndërmarrjeve në varësi, me qëllim rritjen e performancës profesionale të tyre për t'i shërbyer cilësisht komuniteteve, për të përmbushur funksionet dhe kompetencat ligjore të njësive të vetëqeverisjes vendore (NJVV), si dhe për të përballuar me sukses sfidat e NJVV-ve në procesin e integrimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian. Në kuadër të misionit të saj TALGA bën vlerësim të nevojave për trajnim, harton programe trajnimi dhe planet e trajnimeve, administron dhënjen e trajnimeve të vazhdueshme dhe të tjera, përcakton kriteret dhe bën përzgjedhjen e pjesëmarrësve në trajnime, krijon rrjetet e zyrtarëve vendorë për shpërndarjen e njohurive dhe praktikave të mira, administron një platformë të menaxhimit dhe ndarjes së njohurive për zyrtarët e NJVV-ve dhe të interesuar në sektorin e qeverisjes vendore, harton dhe zbaton projekte dhe aktivitetet në fushën e veprimtarisë

së TALGA, ofron ekspertizë dhe shërbime konsulce ndaj NJVV-ve, bashkëpunon me organizata homologe dhe partnerë të ndryshëm për realizimin emisionit të saj, kryen studime dhe zhvillon dokumente politikash në fushën e zhvillimit të kapaciteteve të zyrtarëve të NJVV-ve

2. Të miratojë aktin e themelimit të TALGA-s dhe përfaqësimin e Bashkisë Elbasan në TALGA (SKP), sipas përcaktimeve të statutit të TALGA-s dhe të marrëveshjes bashkëlidhur;
3. Të miratojë efektet financiare të anëtarësimit të Bashkisë Elbasan si anëtare e TALGA (SKP) dhe detyrimin përkatës të pagesës vjetore të kuotës së anëtarësisë, nga fondi i parashikuar për trajnimet në buxhetin e vitit 2025 dhe në Programin Buxhetor Afatmesëm 2025–2027, dhe në shumën e përlogaritur në përputhje me planin e financimit të përbashkët të Këshillit të Ministrave dhe të NJVV-të e tjera anëtare dhe vendimit përkatës së Asamblesë të Përgjithshme të TALGA. Efektet financiare për anëtarësimit dhe detyrimet e pagesave vjetore ndaj TALGA, për tri vitet e para e në vijim, do të përballohen nga të ardhurat e veta të bashkisë.
4. Të autorizojë Kryetarin e Bashkisë Elbasan të nënshkruaj marrëveshjen ndërmjet ministrit përgjegjës për çështjet vendore, i autorizuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 405 dt. 16.07.2025 *“Për autorizimin e ministrit përgjegjës për çështjet vendore për negocimin dhe nënshkrimin e marrëveshjes me njësitë e vetëqeverisjes vendore për krijimin në krijimin e personit juridik si subjekt i kompetencave të përbashkëta me vetëqeverisjen vendore për rritjen e kapaciteteve të qeverisjes vendore të Republikës së Shqipërisë”* dhe njësitë të vetëqeverisjes vendore për krijimin e subjektit të kompetencave të përbashkëta “Akademia e Trajnimit të Njësitë të Vetëqeverisjes Vendore të Republikës së Shqipërisë (TALGA)”, sipas tekstit të marrëveshjes bashkëlidhur këtij vendimi, si dhe të ndërmarrë të gjitha veprimet ligjore dhe administrative dhe të nënshkruajë të gjitha dokumentet administrative për regjistrimin, ngritjen dhe funksionimin e TALGA-s, në përputhje me Statutin dhe Aktin e Themelimit, bashkëlidhur këtij vendimmi, si dhe vendimeve të Asamblesë të TALGA--s;
5. Të autorizojë Kryetarin e Bashkisë të përfaqësojë Bashkinë Elbasan në organet vendimmarrëse, ekzekutive dhe organe të tjera të ngritura me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të TALGA, si dhe të realizojë çdo veprim tjetër për zbatimin e kësaj marrëveshjeje dhe për përmbushjen e detyrimeve që i ngarkohen Bashkisë Elbasan nga kjo marrëveshje, në përputhje me Statutin dhe vendimet e Asamblesë të TALGA-s.

KRYETARI I BASHKISË
Gledian LLATJA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
Këshilli Bashkiak

Nr. _____ Prot.

Elbasan, më _____. _____. 2025

PROJEKT VENDIM

Nr. ____, datë _____. _____. 2025

“PËR

**MIRATIMIN E MARRËVESHJES PËR KRIJIMIN E PERSONIT JURIDIK SI
SUBJEKT I KOMPETENCAVE TË PËRBASHKËTA MIDIS NJËSIVE TË
VETËQEVERISJES VENDORE DHE KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË PËR RRIJTJEN E KAPACITETEVE TE QEVERISJES
VENDORE, AKADEMIA E TRAJNIMIT TË NJËSIVE TË VETËQEVERISJES
VENDORE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË (TALGA)”**

Në mbështetje të nenit 2, pika 11, nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b” dhe nënpika 1.6, shkronja “b”, nenit 14 pika 5, neni 51 pika 4, nenit 54, shkronja “d” dhe “gj”, nenit 55 pikat 3, neni 64 shkronja “h”, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” (i ndryshuar), Ligjit Nr. 8548, datë 11.11.1999 “Për ratifikimin e Kartës Evropiane të Autonomisë Vendore”, Ligjit nr. 8788, datë 07.05.2001 “Për organizatat jofitimprurëse” (i ndryshuar), Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 405, datë 16.07.2025 “Për autorizimin e ministrit përgjegjës për çështjet vendore për negocimin dhe nënshkrimin e marrëveshjes me njësitë e vetëqeverisjes vendore për krijimin në krijimin e personit juridik si subjekt i kompetencave të përbashkëta me vetëqeverisjen vendore për rritjen e kapaciteteve të qeverisjes vendore të Republikës së Shqipërisë”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

VENDOSI:

1. Të miratojë marrëveshjen për krijimin e personit juridik si subjekt i kompetencave të përbashkëta (SKP), në formën e organizatë jofitimprurëse me anëtarësi, midis njësive të vetëqeverisjes vendore të Republikës së Shqipërisë dhe Këshillit të Ministrave të Republikës

së Shqipërisë për rritjen e kapaciteteve të qeverisjes vendore të Republikës së Shqipërisë, dhe anëtarësimin e Bashkisë Elbasan në SKP, të quajtur “Akademia e Trajnimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore të Republikës së Shqipërisë (TALGA)”, bazuar në statutin dhe aktin e themelimit bashkëlidhur këtij vendimi”.

TALGA do të ketë si mision zhvillimin dhe kualifikimin profesional të qëndrueshëm të të zgjedhurve, nëpunësve civilë dhe punonjësve të tjerë të njësive të vetëqeverisjes vendore, përfshirë punonjësit e institucioneve dhe ndërmarrjeve në varësi, me qëllim rritjen e performancës profesionale të tyre për t’i shërbyer cilësisht komuniteteve, për të përmbushur funksionet dhe kompetencat ligjore të njësive të vetëqeverisjes vendore (NJVV), si dhe për të përballuar me sukses sfidat e NJVV-ve në procesin e integritetit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian. Në kuadër të misionit të saj TALGA bën vlerësim të nevojave për trajnim, harton programe trajnimi dhe planet e trajnimeve, administron dhënjen e trajnimeve të vazhdueshme dhe të tjera, përcakton kriteret dhe bën përzgjedhjen e pjesëmarrësve në trajnime, krijon rrjetet e zyrtarëve vendorë për shpërndarjen e njohurive dhe praktikave të mira, administron një platformë të menaxhimit dhe ndarjes së njohurive për zyrtarët e NJVV-ve dhe të interesuar në sektorin e qeverisjes vendore, harton dhe zbaton projekte dhe aktivitetet në fushën e veprimtarisë së TALGA, ofron ekspertizë dhe shërbime konsulce ndaj NJVV-ve, bashkëpunon me organizata homologe dhe partnerë të ndryshëm për realizimin emisionit të saj, kryen studime dhe zhvillon dokumente politikash në fushën e zhvillimit të kapaciteteve të zyrtarëve të NJVV-ve.

2. Të miratojë aktin e themelimit të TALGA-s dhe përfaqësimin e Bashkisë Elbasan në TALGA (SKP), sipas përcaktimeve të statutit të TALGA-s dhe të marrëveshjes bashkëlidhur;
3. Të miratojë efektet financiare të anëtarësimin të Bashkisë Elbasan si anëtare e TALGA (SKP) dhe detyrimin përkatës të pagesës vjetore të kuotës së anëtarësisë, nga fondi i parashikuar për trajnimet në buxhetin e vitit 2025 dhe në Programin Buxhetor Afatmesëm 2025–2027, dhe në shumën e përllogaritur në përputhje me planin e financimit të përbashkët të Këshillit të Ministrave dhe të NJVV-të e tjera anëtare dhe vendimit përkatës së Asamblesë të Përgjithshme të TALGA. Efektet financiare për anëtarësimin dhe detyrimet e pagesave vjetore ndaj TALGA, për tri vitet e para e në vijim, do të përballohen nga të ardhurat e veta të bashkisë.
4. Të autorizojë Kryetarin e Bashkisë Elbasan të nënshkruaj marrëveshjen ndërmjet ministrit përgjegjës për çështjet vendore, i autorizuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 405 dt. 16.07.2025 “Për autorizimin e ministrit përgjegjës për çështjet vendore për negocimin dhe nënshkrimin e marrëveshjes me njësitë e vetëqeverisjes vendore për krijimin në krijimin e personit juridik si subjekt i kompetencave të përbashkëta me vetëqeverisjen vendore për rritjen e kapaciteteve të qeverisjes vendore të Republikës së Shqipërisë” dhe njësive të vetëqeverisjes vendore për krijimin e subjektit të kompetencave të përbashkëta “Akademia e Trajnimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore të Republikës së Shqipërisë (TALGA)”, sipas tekstit të marrëveshjes bashkëlidhur këtij vendimi, si dhe të ndërmarrë të gjitha veprimet ligjore dhe administrative dhe të nënshkruajë të gjitha dokumentet administrative për

regjistrimin, ngritjen dhe funksionimin e TALGA-s, në përputhje me Statutin dhe Aktin e Themelimit, bashkëlidhur këtij vendimmi, si dhe vendimeve të Asamblesë të TALGA-s;

5. Të autorizojë Kryetarin e Bashkisë Elbasan të përfaqësojë Bashkinë Elbasan në organet vendimmarrëse, ekzekutive dhe organe të tjera të ngritura me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të TALGA, si dhe të realizojë çdo veprim tjetër për zbatimin e kësaj marrëveshjeje dhe për përmbushjen e detyrimeve që i ngarkohen Bashkisë Elbasan nga kjo marrëveshje, në përputhje me Statutin dhe vendimet e Asamblesë të TALGA.
6. Ngarkohet Kryetari Bashkisë, Drejtoria e Financave dhe Buxhetit dhe Drejtoria Juridike e Bashkisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, (i ndryshuar).

Sekretari

Sokol SINANI

Kryetari

Lutfi LALA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN

RELACION

Nr. 4149 datë 25.08.2025

Për një ndryshim ne VKB Nr.43 Dt.30.04.2025 “Për miratimin e normave dhe kriterëve për disiplinimin e shpenzimeve për mjete motorrike ne administrim te ASHPU”

Bazuar në:

1. Ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”,neni 54
2. Ligjin nr.10296,datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”
3. Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”

Sipas kontrates Nr. 277/11 Prot,Dt. 08/08/2025 është blerë një mjete i ri, kamioncin 3.5 ton me vinc me targë AB785UK,nr.shasie VWASVTF24E4162292 dhe sipas kontatës Nr.265/10 Prot,Dt 04/08/2025 është blerë një mjete i ri, Fuoristrade me karroceri me targë AB567UO ,nr shasie WFOLMFE10BW943994, të cila është në administrim të Agjencisë së Shërbimeve Publike Urbane Elbasan dhe normativa e konsumit te karburantit është përkatësisht për kamioncinën me 3.5 ton me vinc 13 litra/ore dhe për fuoristradën me karroceri 10 litra/ore referuar procesverbalit për matje faktike te cilin e gjeni bashkëngjitur.

Agjencia e Shërbimeve Publike Urbane Elbasan ka të drejtën dhe përgjegjësinë për të marrë të gjitha masat për kontrollin dhe evidentimin e të gjitha lëvizjeve dhe orëve të punës të automjetit, me qëllim mirëmenaxhimin e konsumit të karburantit, duke zbatuar dispozitat ligjore në fuqi.

Agjencia e Shërbimeve Publike Urbane Elbasan ka të drejtën dhe përgjegjësinë për përballimin me fonde te buxhetit vendor të njësisë shpenzuese , të gjitha shpenzimeve per karburant ,pjesë këmbimi dhe të gjitha taksat dhe detyrimet e tjera ligjore (kolaudim,siguracion,etj)për përdorimin normal të mjeteve motorrike ,duke zbatuar dispozitat ligjore në fuqi.

Konceptoi: S.Finance Blerina Kotorri

P/Sek Teknik dhe mekanik Erind Osmani

Pranoi: Dr. Pergj Agron Lulaj

Miratoi

KRYETARI

Gledian LLATJA

Në mungesë dhe me porosi
ZV/Kryetari

Klaudia KRASNIKA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
AGJENCIA SHERBIMEVE PUBLIKE URBANE

Nr. _____ Prot

Dt. _____. _____. 2025

PROJEKT VENDIM

“Për një ndryshim ne VKB Nr.43 Dt.30.04.2025 “Për miratimin e normave dhe kriterëve për disiplinimin e shpenzimeve për mjete motorrike ne administrim te ASHPU”

Bazuar në:

1. Ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”,neni 54
2. Ligjin nr.10296,datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”
3. Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”

VENDOSI:

- 1.Të miratojë normativat e konsumit të karburantit për mjetet e reja (Fuoristrade me karroceri me targe AB567UO dhe Kamioncin me 3.5 ton me vinc me targe AB785UK) në administrim të Agjencisë së Shërbimeve Publike Urbane Elbasan
- 2.Ngarkohet Drejtori i Agjencisë së Shërbimeve Publike Urbane Elbasan për zbatimin e këtij vendimi.
- 3.Ky vendim hyn në fuqi 10 dite pas shpalljes.

Konceptoi:S.Finance Blerina Kotorri

Sekretari i Këshillit Bashkiak
Sokol Sinani

Kryetari i Keshillit Bashkiak
Lutfi Lala



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
AGJENCIA E SHERBIMEVE PUBLIKE URBANE

PROCES VERBAL

Prot 428

Dt 21/08/2025

PROCES VERBAL

I mbajtur sot me date 21-08-2025 nga komisioni I perbere nga: Kristi Muca me detyre pergjegjes I sektorit mirmbajtje rruge trotuare , Ramiz Pisha pergjegjes I sektorit te siperfaqeve te gjelberta dhe Graciano Dunja me detyre magazinier nafte dhe rekupero mbahet ky procesverbal per percaktimin e norms se harxhimit te karburantit per mjetin tip kamioncine Nissan me vinc, me targa AB785UK, vit prodhim 2014.

Per percaktimin e normes se harxhimit te karburantit, komisioni beri matjen faktike duke pershkruar rruge qyteti dhe segmentin rrugor me itenerarin Elbasan-Tirane-Elbasan , me distance totale prej 100 kilometrash, rezultoi se makina konsumoi **13 litra nafte per 100 km.**

KOMISIONI:

Kristi Muca

Ramiz Pisha

Graciano Dunja



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
AGJENCIA E SHERBIMEVE PUBLIKE URBANE

PROCES VERBAL

Prot 429

Dt. 22/08/2025

I mbajtur sot me date 22.08.2025 nga komisioni I perbere nga: Kristi Muca me detyre pergjegjes I sektorit mirmbajtje rruge trotuare , Ramiz Pisha pergjegjes I sektorit te siperfaqeve te gjelberta dhe Graciano Dunja me detyre magazinier nafte dhe rekupero mbahet ky procesverbal per percaktimin e norms se harxhimit te karburantit per mjetin tip Ford Ranger me targa AB567UO, vite prodhim 2011.

Per percaktimin e normes se harxhimit te karburantit, komisioni beri matjen faktike duke pershkruar rruge qyteti dhe segmentin rrugor me itenerarin Elbasan-Tirane-Elbasan , me distance totale prej 100 kilometrash, rezultoi se makina konsumoi **10 litra nafte per 100 km.**

KOMISIONI:

Kristi Muca 

Ramiz Pisha 

Graciano Dunja 

LISTA MAKINERIVE

ADMINISTRATA

Nr	Targa e mjetit	Tipi I mjetit	Norma e konsumit	KARBURANTI
1	AB 576 DF	Volkswagen	9 Litra/100 km Ne muaj 400Litra	Gazoil D 1
2	AA 101 DC	Volkswagen	9 Litra/100 km Ne muaj 250 litra	Gazoil D 1
3	AA 256 EG	Benz Mercedes	12 Litra/100 km Ne muaj 250 litra	Gazoil D 1

AGJENCIA E SHERBIMEVE PUBLIKE URBANE

	Targa e mjetit	Tipi imjetit	Norma e konsumit	Karburanti
		AUTOVINCAT		
1	Autovinc JMC	AB721SN	12 Litra/Ore	Gazoil D1
		FADROMAT		
2	AB197NP	FadromeFermec	8 litra / 1 ore pune	Gazoil D 1
3	Fadromë me agregat	AO MT 63	14 Litra/Ore	Gazoil D1
		KAMIONCINAT		
4	AB102NP	Kamioncine Benz 3.7 Ton	17 litra / 100 km	Gazoil D 1
5	AB 864 CK	Kamioncin ford tranzit	12 litra /100 km	Gazoil D 1
		FORISTRADAT		
6	TR 3690 S	Mitsubishi L 200	12 litra / 100 km	Gazoil D 1

MJETE TE REJA AGJENCIA SHERBIMEVE PUBLIKE URBANE

Nr	Mjete te reja	Targa	Norma e konsumit	Karburanti
<u>1</u>	<u>Fuoristrade</u> <u>me karroceri</u>	<u>AB567UO</u>	<u>10 Litra/Ore</u>	<u>Gazoil D1</u>
<u>2</u>	<u>Kamioncin</u> <u>3.5ton me vinc</u>	<u>AB785UK</u>	<u>13 Litra/Ore</u>	<u>Gazoil D1</u>

Konceptoi:

Spec/Finance Blerina Kotorri

Miratoi

Magazinier nafte/rekupero:

Graciano Dunja

Drejtori I Pergjithshem

Agton Lulaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E KUJDESIT SOCIAL, ARSIMIT, RINISË DHE
SPORTEVE
DREJTORIA E MBROJTJES DHE PËRFSHIRJES SOCIALE

Nr. 9027 Prot.

Elbasan, më 12/08/2025

RELACION
KËSHILLIT BASHKIAK

Lënda: Relacion për Planin Vendor të Veprimit të Mbrojtjes Sociale 2025-2028

Të nderuar anëtarë të Këshillit Bashkiak,

Në zbatim të parimeve të qeverisjes vendore, në përputhje me prioritetet e politikave sociale kombëtare dhe në funksion të nevojës për përmirësimin e vazhdueshëm të mekanizmave të mbrojtjes sociale në nivel vendor, Bashkia Elbasan ka ndërmarrë një proces rishikimi të Planit Vendor të Veprimit të Mbrojtjes Sociale 2024-2027.

Arsyet e rishikimit:

1. Ndryshimet sociale dhe demografike

Në vijim të analizave të kryera nga strukturat e Bashkisë dhe institucioneve partnere:

- Është vërejtur një ndryshim në përbërjen demografike të popullsisë, përfshirë rritjen e përqindjes së grupmoshave të moshuara, si dhe zhvendosjen e popullsisë nga zonat rurale drejt zonave urbane.
- Janë konstatuar rritje të rasteve të vulnerabilitetit social, të lidhura me faktorë ekonomikë, papunësinë, ndryshimet në strukturën familjare, emigracionin etj.
- Është e nevojshme të përditësohen prioritetet dhe masat ndërhyrëse, për të qenë në përputhje me realitetin e ri shoqëror dhe për të ofruar shërbime më efektive dhe gjithëpërfshirëse.

2. Shtesë specifike për pakicat rome dhe egjiptiane

Nisur nga fakti që Plani Vendor i Veprimit të Mbrojtjes Sociale aktual 2024-2027 nuk kishte të përfshirë masa që mundësojnë integrimin e pakicave rome e egjiptiane si pasojë e ekzistencës së Planit Vendor për Integrimin e Pakicave Rome dhe Egjiptiane 2019-2022 (miratuar me vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 43, më 30 prill 2020), u pa e nevojshme përfshirja e masave për integrimin e këtyre pakicave në Planin Vendor të Veprimit të

Mbrojtjes Sociale 2025-2028. Duke marrë parasysh edhe rekomandimet e dala nga proçeset e konsultimit publik dhe nga raportet takimeve me Grupin e Punës, aktorë të tjerë si edhe me përfaqësues të organizatave që punojnë me pakicat rome dhe egjiptiane:

- Është identifikuar nevoja për një përfshirje më të gjerë dhe të thelluar të këtyre komuniteteve në politikat dhe programet sociale të Bashkisë.
- Plani i rishikuar parashikon një shtojcë të dedikuar për pakicat rome dhe egjiptiane, ku përfshihen masa të posaçme për përmirësimin e aksesit në shërbime sociale, regjistrim civil, kujdes shëndetësor, strehim social, arsim dhe punësim;

Përmbajtja e rishikimit

Plani i rishikuar ruan strukturën bazë të dokumentit fillestar, por përfshin:

- Përditësimin e të dhënave statistikore;
- Rishikimin e objektivave strategjike dhe veprimeve prioritare;
- Shtojcën për pakicat rome dhe egjiptiane;
- Masa të reja për përfshirjen e të rinjve, grave në nevojë, personave me aftësi të kufizuara, dhe të moshuarve.

Përfundim

Ky rishikim synon të rrisë efektivitetin, gjithëpërfshirjen dhe qëndrueshmërinë e politikave të mbrojtjes sociale në nivel vendor. Plani është hartuar në bashkëpunim me aktorë lokalë, përfaqësues të shoqërisë civile dhe komunitetet në nevojë, duke reflektuar një qasje sa më afër realitetit dhe nevojave të qytetarëve.

Kërkojmë miratimin nga Këshilli Bashkiak për këtë rishikim të Planit Vendor të Veprimit të Mbrojtjes Sociale 2025-2028, në mënyrë që të vijojë më tej zbatimi i tij në përputhje me objektivat zhvillimore të Bashkisë dhe parimet e barazisë sociale.

Duke ju falenderuar !

Konceptoi: Përgj.sek L.Senia

Miratoi: Dr.M.P.S. E.Kolla

Pranoi: Dr.P.K.S.A.R.S D. Roseni

KRYETAR

Gledian Llatja

ME URDHËR E POROSI

Zv/KRYETAR

Armand Shehu





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr _____ prot

Elbasan me . ____ . 2025

PROJEKT-VENDIM

Nr. ____, datë ____/____/2025

Mbi miratimin për Planin Vendor të Veprimit të Mbrojtjes Sociale 2025-2028”.

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të datës ____/____/2025, pasi shqyrtoi rishikimin e Planit Vendor të Veprimit të Mbrojtjes Sociale 2025-2028 i paraqitur nga Drejtoria e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale, në mbështetje të nenit 28/1 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligji nr.9970 datë 24.07.2008 “Për barazinë gjinore në shoqëri” Ligji Nr.121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në republikën e Shqipërisë” Ligji nr 68/2017 “Për financat e vetqeverisjes vendore” Ligji Nr.93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuar” Ligji 125/2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar Ligji 124/2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr.221/04.02.2010 për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar

VENDOSI

- 1.Të miratojë Planin Vendor të Veprimit të Mbrojtjes Sociale 2025-2028 ”.
- 2.Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas miratimit në Këshillin Bashkiak.

Drejtori DMPS E.Kolla

Drejtori Juridik A.Hoxha

Drejtori Buxhet-Financë A.Merkja

Sekretar i Këshillit Bashkiak

Sokol Sinani

Kryetar i Këshillit Bashkiak

Lutfi LALA



BASHKIA ELBASAN
AGJENCIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE RURALE
DREJTORIA E BUJQËSISË DHE PYJEVE

Adresa: Bashkia Elbasan, Rr. "Q.Stafa", Tel. +355 54 400152, e-mail bashkiaelbasan@elbasani.gov.al web: www.elbasani.gov.al

Nr 4164 prot

Elbasan më 26/08/2025

RELACION MBI PROJEKT- VENDIMIN

**Për miratimin, paraparak të Planit të Mbarështrimit të Ekonomisë Pyjore:
"Kushë-1" dhe "Zaranikë".**

Të nderuar këshilltarë!

Mbështetur në nenin nr. 11 të ligjit nr. 57/2020, datë 30/04/2020 "Për pyjet"; ligjin nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar; V.K.M nr. 433, datë 08.06.2016 "Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listës së inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/bashkive" të ndryshuar; Kontratën (Shërbim konsulence) nr. 172/9 prot, datë 08.07.2024 "Hartim të Planit të Mbarështrimit për ekonominë pyjore "Kushë-1" dhe "Zaranikë" e lidhur midis subjektit juridik, **Bashkimi i Shoqërive "XHET"sh.p.k & "DEJA sh.p.k** dhe Bashkisë Elbasan; Urdhërin nr. 189, datë 26.09.2024 dhe të titullarit të Bashkisë Elbasan "Për emërimin e supërvizorëve për mbikqyerjen e shërbimit të kontratës për hartimin e Planeve të Mbarështrimit të ekonomive pyjore "Kushë-1" dhe "Zaranikë".

Fondi pyjor/kullor i transferuar në pronësi të Bashkisë Elbasan, shtrihet dhe menaxhohet nga pikpamja teknike në kuadrin e 15 ekonomive pyjore. Ekonomia pyjore është njësi bazë e organizimit dhe menaxhimit të sipërfaqes së fondit pyjor kombëtar, për qeverisjen e pyjeve, për drejtimin, planifikimin e kontrollin e mbarështrimit të pyjeve, që zakonisht përfshin një masiv pyjor me kufij të qartë natyror.

Mbarështimi i pyjeve realizohet në përputje me politikat dhe programin kombëtar të pyjeve duke garantuar ruajtjen, zhvillimin dhe ripërtëritjen e fondit pyjor kombëtar, sigurimin e kushteve për shfrytëzimin e tij në përputhje me prioritetet e ekonomisë kombëtare, plotësimin e nevojave të komuniteteve lokale duke siguruar vaxhdueshmërinë e riprodhimit nëpërmjet ripërtëritjes kryesisht natyrore. Mbarështrimi i pyjeve përshtatet dhe plotësohet në përputhje me ndryshimet e gjendjes së fondit pyjor kombëtar, si dhe me ndryshimet e shoqërore dhe ekonomike të vendit.

Plani i mbarështimit si dokument bazë afatgjatë për pyjet, për realizimin e qeverisjes, zhvillimin dhe mbrojtjen e tyre, ligjërisht është i vlefshëm për një periudhë kohore 10 vjeçare nga data e miratimit të tij nga strukturat shtetërore të miratuarav me ligj. Mbështetur në ligjin bazë të pyjeve nr. 57/2020, datë 30/04/2020, planet e mbarështrimit hartohen nga pronari (aktualisht bashkia) nga ekspertë të certifikuar të fushës së pyjeve, bazuar në metodikat/udhëzuesit e përgatitur nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit.

Sa më sipër, hartimi i Planeve të Mbarështimit të Pyjeve është i një rëndësie jetike në planifikimin dhe zbatimin më pas të të gjitha aktiviteteve në teritorin fizik të sipërfaqes së një ekonomie pyjore, përfshi këtu dhe plotësimin e nevojave me dru zjarri për komunitetet lokale në zonat rurale, nevojat e enteve publike (shkollat, çerdhet etj), por dhe të banorëve të qyteti si dhe të gjitha produktet e tjera drusore e jo drusore që gjenden dhe dalin nga fondi pyjor i kësaj ekonomie pyjore.

Paraprakisht duhet thënë së nga 15 ekonomi pyjore që përfshihet fondi pyjor i Bashkisë Elbasan, deri me sot vetëm 10 ekonomi pyjore kanë plane mbarështimi të vlefshme (janë hartuar dhe miratuar nga viti 2019 e në vijimësi, çdo vit), ndërsa ekonomitë e tjera pyjore nuk kanë plane mbarështimi (kanë plane inventarizimi të viteve 1984-85) ose kanë plane mbarështimi të pavlefshme (kanë mbi 10 vjet të miratuara), që aktualisht nuk kanë bazë ligjore për të marrë informacion e nevojshëm teknik dhe të planifikosh aktivitete për keto ekonomi pyjore.

Nisur nga kjo emergjencë, Bashkia Elbasan, çdo vit ka planifikuar fonde financiare në buxhetet vjetore për të mbështetur hartimin e planeve të mbarështimit, nëpërmjet prokurimit të hapur publik (shërbim konsulence), me pjesmarrjen e subjekteve të licensuara në këtë fushë.

Për hartimin e planit të mbarështimit, për ekonomitë pyjore “Kushë-1” dhe “Zaranikë”, filloi prokurimi i hapur publik (shërbim konsulence) që në Maj 2024.

Meqenëse kjo forme prokurimi kërkon një afat kohor të konsiderueshme pasi zhvillohet në tre faza dhe për këtë më pas u arrit të shpallej fitues dhe lidhet kontrata e shërbimit me Bashkinë Elbasan përkatësisht subjekti bashkimit e shoqërive ekonomik “Xhet sh.p.k & Deja sh.p.k” dhe lidhjen e kontratës së shërbimit nr. 172/9 prot, datë 08.07.2024 me objekt “Për Hartimin e planit të mbarështimit të ekonomive pyjore “Kushë-1” dhe “Zaranikë”.

Meqenëse këto kontrata shërbimi monitorohen nga Bashkia Elbasan, me urdhërin nr. 189, datë 26.09.2024 “Për emërimin e supërvizorëve për mbikqyerjen e shërbimit për hartimin e planit të mbarështimit të ekonomive pyjore “Kushë-1” dhe “Zaranikë” të titullarit të bashkisë u ngrit një grup pune prej tre specialistë të fushës së pyjeve, me eksperiencë në këtë fushë (siç dhe e kërko ligji) për të monitoruar marrjen dhe zbatimin e punimeve të terrenit dhe punimeve të zyrës të kompanive kontraktuese.

Bazuar dhe në kushtet e kontratës së lidhur midis këtyre subjekteve nga njëra anë dhe Bashkisë Elbasan nga ana tjetër (kontraktori) në të cilën disbursimi i fondeve do të bëhet në tre faza, në të cilën faza e parë dhe dytë ka të bëjë me fillimin e zbatimit të aktivitetit të këtij subjekti në ekonomitë pyjore “Kushë-1” dhe “Zaranikë”, marrjen e rezultateve të matjeve dentrometrike (inventarizimi me sipërfaqë provë), përshkrimin parcellar sipas formatit të miratuar dhe çdo informacion tjetër i domosdoshëm i përcaktuar në termat e referencës për këtë procedurë prokurimi.

Ndërsa faza e tretë (përfundimtare) do të disbursohet pasi plani i mbarështimit do të marrë miratimin përfundimtar nga strukturat e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, periudhë pas së cilës plani i mbarështimit merr fuqi ligjore dhe konsiderohet i vlefshëm për një periudhë kohore prej 10 vjet.

Grupi i punës i ngritur me urdhër të Titullarit të Bashkisë, për monitorimin e kësaj kontrate, ka monitoruar në mënyrë permanente aktivitetin e këtyre kompanive dhe pasi është bindur nëpërmjet kontrolleve, se subjekti ka zbatuar me korrektësi standartet sipas Manualit e Planeve të Mbarështimit të Pyjeve dhe Kullotave 2019, miratuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, me nr. 864 prot, datë 30.01.2019, ka bërë dhe certifikimin e punës së kryer e cila më pas shërben dhe si dokument bazë për disbursimin e fondeve financiare nga Drejtoria e Financës dhe Buxheti e bashkisë.

Sa më sipër, ndarë sipas fazave është bërë monitorimi në teren dhe janë bërë certifikimet nga grupi i punës së monitorimit:

Subjekti: Bashkimi i Shoqërive “XHET & DEJA” sh.p.k:

- Faza e parë: Çertifikuar me datë 07.10.2024
- Faza dytë: Çertifikuar me datë 20.05.2025

Ndërsa, sa i përket fazës së tretë, subjekti kontraktues ka përfunduar përlllogaritjet dhe përpunimin e të dhënave të terrenit dhe më pas kanë hartuar draft projektet e mbarështimit për secilën nga ekonomitë pyjore objekt i kontratës me Bashkinë Elbasan.

Për ç'do fazë, paraprakisht subjekti kontraktor (para certifikimit) ka dërguar materialet shkresore pranë Drejtorisë së Pyjeve, me të dhënat e nevojshme në formën e një raporti të përmbledhur, për të gjitha operacionet e aktiviteteve të zhvilluara në terren.

Disa të dhëna bazë, qw kanw dalw nga pwrfundimi i matjeve nw terren dhe pwrpunimi i tyre, për secilën nga ekonomitë pyjore, objekt i kësaj kontrate, po ju paraqesim për miratim paraprak, janë:

❖ Ekonomia Pyjore “**Kushë-1**”:

- **Sipërfaqe totale**= **4439,73 ha, nga kjo:**
- Pyje (të larte + shkurre).....= 2493,72 ha
- Kullota, livadhe.....= 12,35 ha
- Të tjera.(improduktive,urbane, ujore etj)...= 522,49 ha
- Tok bujqësore.....= 1411.17 ha

❖ Ekonomia Pyjore “**Zaranikë**”:

- **Sipërfaqe totale**= **7023,2 ha, nga kjo:**
- Pyje (të larte + shkurre).....= 3289,8 ha
- Kullota, livadhe.....= 317,2 ha
- Të tjera.(improduktive,urbane, ujore etj)...= 1173,9 ha
- Tok bujqësore.....= 2243,2 ha

Draft planet e mbarështimit të ekonomive pyjor, për të cilat ju paraqesim për miratim paraprak paraqesin një sërë informacionesh të nevojshme mbi gjendjen e grumbujve pyjore/kullosorë si dhe masat e parashikuara për periudhën 10 vjeçare të ndërhyrjeve të mundëshme, për përmirësimin e gjendjes aktuale dhe për plotësimin e nevojave të banorëve të Bashkisë Elbasan me produkte drusore dhe prodhime të dyta pyjore (Bime Mjeksore, Tanifere, Eterovajore Natyrore; produkte dhe fruta natyrore; gurë, rërë, Zhavor, humus etj).

Draftet e Projekteve të Planeve të Mbarështimit pasi janë kontrolluar me shum përgjegjësi nga grupi i punës, janë bërë vërejtjet e gjetura dhe subjektet më pas pasi kanë bërë rregullimet e nevojshme, bazuar në vërejtjet e konstatuara, kanë sjellë sëfundëmi draft palnet e mbarështimit për ekonomitë pyjore “Kushë-1” dhe “Zaranikë” të cilat bazuar në kërkesat e ligjit nr. 57/2020, datë 30/04/2020 “Për pyjet” neni 11, pika 2/b, ku paraprakisht, para miratimit përfundimtar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, kërkohet miratimi paraprak nga Këshilli Bashkiak.

Sa më sipër, **kërkojmë nga ana Juaj, miratimin në parim të planit të mbarështimit të ekonomisë pyjore: “Kushë-1” dhe “Zaranikë”.**

Ju faleminderit për mirkuptimin !

KRYETARI
Gledian Llatja

ME URDHËR E POROSI
ZV/KRYETARI
Asim Sula





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA ELBASAN
KRYETARI I BASHKISË**

Adresa: Bashkia Elbasan Rruga "11 Nëntori", Tel. +355 54 400152, E_mail bashkiaeelbasa@elbasani.gov.al

Nr. _____ prot.

Elbasan, më _____.2025

Lënda : Dërgohet projekt vendimi.

**KËSHILLIT TË BASHKISË
ELBASAN**

Në zbatim të detyrimeve që dalin nga ligji nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ligji nr. 57, datë 30.04.2020 "Për Pyjet", bashkëlidhur ju dergojmë projekt vendimin "Për miratimin paraprak të Planit të Mbarështrimit të Ekonomisë Pyjore: "Kushë-1" dhe "Zaranikë".

Bashkëlidhur projekt vendimit do të gjeni:

1. Relacioni i hartuar nga Sektori i Pyjeve nr. _____ prot. datë _____.08.2025.
2. Projekt Vendim "Për miratimin paraprak të Planeit të mbarështrimit të ekonomisë pyjore: "Kushë-1" dhe "Zaranikë".

Me respekt
KRYETARI
Gledian Llatja

PERSONI I AUTORIZUAR PREJ TIJ
ZV.KRYETARI
Asim Sula

Të dhënat e projekt vendimit:¹

Nr. i faqeve A4 të projekt vendimit: _____

Nr. i faqeve A4 të relacioni shoqërues: _____

Nr. i fletëve të dokumenteve që shoqërojnë projekt vendimin: _____



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK**

PROJEKT VENDIM

Nr. ____ datë: _____.2025

**PËR MIRATIMIN PARAPRAK TË PLANIT TË MBARËSHTRIMIT TË EKONOMISË
PYJORE “KUSHË-1” DHE “ZARANIKË”.**

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar; V.K.M nr. 433, datë 08.06.2016 “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listës së inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/bashkive” të ndryshuar; ligjit nr. 57/2020 “Për pyjet” neni 11.

KËSHILLI BASHKIAK

V E N D O S I

1. Të miratojë në parim Planin e mbarështrimit të ekonomive pyjore “Kushë-1” dhe “Zaranikë”.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Bujqësisë dhe Pyjeve (A.SH.P.R).
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”).

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Sokol Sinani

KRYETARI

Lutfi Lala

Konceptoi: Jakov Bodurri

Pranoi: Klajd Gripshi

Miratoi: Altin Cenelli

Konfirmoi: Arben Hoxha



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
DREJTORIA MONITORIMIT
SEKTORI STATISTIKAVE DHE PERFORMANCËS

Nr. 3825 prot.

Elbasan, më 30.07.2025

Relacion

**PËR MIRATIMIN E “PLANIT TË INTEGRITETIT TË BASHKISË ELBASAN
2025–2028”**

Drejtuar Këshillit Bashkiak

Qëllimi i relacionit

Ky relacion i paraqitet Këshillit Bashkiak për miratimin e “Planit të Integritetit 2025–2028” të Bashkisë Elbasan, dokument trevjeçar kornizë që synon **parandalimin e korrupsionit, rritjen e transparencës, llogaridhënies dhe kulturës së etikës** në administratën vendore.

2. Baza ligjore dhe strategjike

Plani mbështetet në:

- VKM nr. 241, datë 18.04.2018, “Për miratimin e Dokumentit të Politikave për Integritetin në Sektorin Publik” dhe aktet nënligjore në zbatim;
- Strategjinë Kombëtare Antikorrupsion 2024–2030;
- Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;
- Kuadrin për menaxhimin e riskut institucional, etikën dhe konfliktin e interesit (ILDKPKI; VKM nr. 873, datë 24.11.2021 për rregullat e etikës në administratën publike);

- Parimet e **OGP Local** për qeverisje të hapur, pjesëmarrje qytetare dhe transparencë.

3. Qasja dhe procesi i hartimit

Plani është hartuar nga grupi i punës ndërsektorial nën koordinimin e Drejtorisë së Monitorimit dhe Drejtorisë së Integritetit, duke ndjekur këto hapa:

- **Vlerësimi fillestar** i gjendjes (analiza e riskut të integritetit, ankesat, auditimet, ILDKPKI, praktikat e transparencës, kanalet e sinjalizimit);
- **Konsultimet** me drejtoritë, NjA-të, Këshillin Bashkiak, OJF-të, forumet qytetare dhe partnerët e OGP;
- **Hartimi i objektivave, masave, treguesve (KPI), afateve dhe përgjegjësi;**
- **Planifikimi i monitorimit** tremujor/periodik dhe raportimit vjetor.

Konsultim publik: Drafti do të publikohet në faqen zyrtare të Bashkisë dhe në sportelet e informacionit për **30 ditë kalendarike**; do të organizohen prezantime me grupet e interesit dhe përmbledhja e komenteve do të aneksohet në dosjen e miratimit.

4. Vizion, qëllime dhe objektiva strategjike

Vizioni: Bashkia Elbasan të jetë institucion me **standarde të larta integriteti**, të hapur, me vendimmarrje të gjurmueshme dhe me **besim publik të rritur**.

Qëllimi: Konsolidimi i sistemeve të parandalimit të korrupsionit dhe forcimi i etikës institucionale përmes mekanizmave të matshëm, digjitalë dhe pjesëmarrës.

Objektivat strategjike (2025–2028):

1. **OS-1: Konsolidimi i Sistemit të Integruar të Menaxhimit të Riskut të Integritetit (SIMRI)**
 - Hartimi/azhurnimi i hartës së riskut; kontrolle parandalimi; audit i brendshëm tematik.
2. **OS-2: Transparencë & Llogaridhënie**

- Rritja e publikimeve proaktive; buxheti i hapur; gjurmueshmëria e vendimmarrjes; të dhëna të hapura.
- 3. **OS-3: Zhvillim i Burimeve Njerëzore**
 - Kodi i sjelljes; trajnime periodike për etikë/konflikt interesi/sinjalizim; vlerësim performance lidhur me integritetin.
- 4. **OS-4: Mekanizma të Pjesëmarrjes Qytetare**
 - Konsulta të rregullta, platforma digjitale për sugjerime/ankesa/sinjalizime, forume komunitare.

5. Masat kryesore (përmbledhje)

- **Rregullore & standarde:** Azhurnohet Kodi i Etikës; procedura për konfliktin e interesit, dhuratat dhe sinjalizimin.
- **Transparencë proaktive:** Kalendar publikimesh; data set-e prioritarë; publikim raportesh monitorimi.
- **Sinjalizim & ankesat:** Platformë e unifikuar; SLA për trajtim; raportim i statistikave.
- **Menaxhim risku:** Regjistër risku; plane trajtimi; verifikime tematikë.
- **Trajnime:** Kurrikul vjetor për stafin; module onboarding për integritetin.
- **Pjesëmarrje:** Konsulta periodike, buxhetim i hapur, OGP forum lokal.
- **Digjitalizim:** Automatizim i gjurmueshmërisë së akteve dhe prokurimeve; dashboard-i i integritetit.

6. Treguesit e matjes (KPI – shembuj)

- % e publikimeve të realizuara sipas kalendarit;
- Koha mesatare e trajtimit të ankesave/sinjalizimeve;
- Nr. i trajnimeve dhe përfshirja (% stafi);
- % e rekomandimeve të auditit të zbatuara brenda afatit;
- Indeksi i transparencës / kënaqësia e qytetarëve nga konsultimet.

7. Kosto, burime dhe afate

- Zbatimi parashikohet në periudhën **2025–2028**, me plane vjetore veprimi dhe **buxhetim të integruar** në PBA dhe programe/drejtoritë përkatëse.
- Kostot mbulohen nga buxheti vendor dhe, kur të jetë e mundur, nga projekte partnere (donatorë/OGP).

- Nuk krijohen detyrime të reja të pambuluara buxhetore; çdo masë shoqërohet me preventiv dhe burim financimi.

8. Monitorim dhe raportim

- **Monitorim tremujor** nga Drejtoria e Monitorimit & Drejtoria e Burimeve Njerëzore;
- **Raportim vjetor** te Kryetari i Bashkisë dhe Këshilli Bashkiak; publikim në faqen zyrtare;
- **Rishikim i mes-mandatit (2027) dhe rishikim final (2028).**

9. Pritshmëritë dhe përfitimet

- Ulje e riskut të shkeljeve etike dhe korrupsionit;
- Rritje e besimit publik dhe cilësisë së shërbimeve;
- Standardizim i proceseve dhe gjurmueshmëri më e lartë;
- Rritje e transparencës dhe pjesëmarrjes qytetare.

10. Kërkesa për miratim

Në mbështetje të sa më sipër, i propozohet Këshillit Bashkiak:

1. **Miratimi** i “Planit të Integritetit të Bashkisë Elbasan 2025–2028”;
2. Ngarkimi i administratës për **zbatimin** e planit sipas masave, afateve dhe përgjegjësi të përcaktuara;
3. **Raportim vjetor** pranë Këshillit Bashkiak mbi ecurinë e zbatimit dhe rezultatet.

Konceptoi: Koorditore L.Haxhiymeri
Pranoi: Drejtori T.Sinanaj
Miratoi: Drejt.Pergj. Sh.Cullhaj

ZV/KRYETARI

Asim SULA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
Këshilli Bashkiak

Nr. _____ Prot.

Elbasan, më ____ . ____ . 2025

PROJEKT VENDIM

Nr. ____, datë ____ . ____ . 2025

PËR MIRATIMIN E “PLANIT TË INTEGRITETIT 2025-2028” TË BASHKISË ELBASAN

Këshilli Bashkiak, në mbledhejn e tij të datës ____ / ____ / 2025, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga administrata e Bashkisë, Drejtoria e Monitorimit, mbi miratimin e Planit të Integritetit 2025- 2028 , mbështetur në:

- Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;
- VKM nr. 241, datë 18.04.2018 “Për miratimin e Dokumentit të Politikave për Integritetin në Sektorin Publik”;
- VKM nr. 873, datë 24.11.2021 “Për miratimin e rregullave të etikës në administratën publike”;
- Kuadrin kombëtar të integritetit dhe etikës në sektorin publik;
- Strategjinë Kombëtare Antikorrupsion 2024–2030;
- Relacionin shoqërues të paraqitur nga Drejtoria e Monitorimit

Vendosi

- 1- Miratohet “Kodi i Sjelljes 2025” i Bashkisë Elbasan, sipas tekstit bashkëngjitur këtij vendimi, i cili është pjesë përbërëse e tij.
- 2- Ngarkohet Drejtoria e Administratës dhe Burimeve Njerëzore, Koordinator i Integritetit dhe administrata e Bashkisë për:
 - integrimin e masave të planit në programet e zhvillimit të kapaciteteve dhe për organizimin e trajnimeve për stafin;;

- për monitorimin e zbatimit të Planit, raportimin periodik dhe adresimin e çështjeve të etikës dhe integritetit;
- për zbatimin e masave të përcaktuara në plan sipas afateve dhe përgjegjësive të tyre.;
- raportimin mbi ecurinë e zbatimit të Planit të Integritetit i cili do të bëhet **çdo vit** pranë Këshillit Bashkiak dhe do të publikohet në faqen zyrtare të Bashkisë për transparencë publike

3- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

<u>Konceptoi:</u>	Koordinatori	L.Haxhiymeri
<u>Pranoi:</u>	Drejtori M.	T.Sinanaj
<u>Miratoi:</u>	Drejt. Pergj.	Sh.Çullhaj
<u>Pranoi:</u>	Drejt Juridike	A.Hoxha
<u>Konfirmoi:</u>	ZV/Kryetar	A.Sula



Sekretari

Sokol SINANI

Kryetari

Lutfi LALA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
DREJTORIA MONITORIMIT
SEKTORI STATISTIKAVE DHE PERFORMANCËS

Nr. 3652 prot.

Elbasan, më 18.07.2025

Relacion

PËR MIRATIMIN E “KODIT TË SJELLJES 2025, BASHKIA ELBASAN”

1. Qëllimi i relacionit

Ky relacion i paraqitet Këshillit Bashkiak për miratimin e Kodit të Sjelljes të Bashkisë Elbasan, dokument normativ që përcakton parimet, rregullat e etikës, standardet e integritetit, konfliktin e interesit, dhuratat, sjelljen brenda dhe jashtë mjediseve të punës, si dhe rregullat e komunikimit me publikun për të gjithë punonjësit e administratës së Bashkisë dhe njësisë vartëse.

2. Baza ligjore dhe strategjike

Kodi hartohet dhe zbatohet në përputhje me:

- **Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;**
- **Kuadrin kombëtar të integritetit dhe etikës** (udhëzime ILDKPKI për konfliktin e interesit dhe sinjalizimin e brendshëm);
- **VKM nr. 873, datë 24.11.2021** (rregullat e etikës në administratën publike) dhe aktet nënligjore përkatëse;
- **Legjislacionin për të drejtën e informimit dhe transparencën;**
- **Strategjitë kombëtare për antiekorrupsion dhe qeverisje të hapur (OGP Local).**

3. Procesi i hartimit dhe konsultimit

Kodi është përgatitur nga grupi i punës ndërsektorial nën koordinimin e Drejtorisë së Integritetit dhe Drejtorisë së Monitorimit, me këto hapa:

- **Rishikim** i Kodit ekzistues (2019) dhe i praktikave të brendshme;
- **Përputhje** me VKM/udhëzimet e reja dhe aktet për konfliktin e interesit, sinjalizimin dhe dhuratat;
- **Konsultim publik 30-ditor** në faqen zyrtare dhe takime me drejtori, sindikata/forume, OJF dhe OGP;
- **Integrim komentesh** dhe finalizim për miratim.

4. Fusha e zbatimit

Kodi zbatohet për:

- Të gjithë punonjësit me marrëdhënie pune/shërbimi civil në Bashki dhe institucionet vartëse;
- Personelin me kontrata të projekteve, praktikantët dhe personat në detyra përfaqësimi, gjatë kryerjes së funksioneve.

5. Përmbajtja kryesore e Kodit (përmbledhje)

- **Parimet bazë:** ligjshmëria, paanësia, integriteti, profesionalizmi, shërbimi ndaj qytetarëve, respekti dhe barazia.
- **Konflikti i interesit:** parandalim, vetëdeklarim, menaxhim dhe sanksione; regjistër i deklarimeve.
- **Dhuratat dhe përfitimet:** rregulla, pragje, refuzim/raportim; regjistër dhuratash.
- **Përdorimi i pasurisë publike & informacionit:** ndalim i përdorimit privat, ruajtja e konfidencialitetit, siguria e të dhënave.
- **Komunikimi me publikun & mediat:** qartësi, saktësi, etikë; kanalet zyrtare; sjellja në rrjete sociale.
- **Marrëdhëniet në punë:** dinjitet, mosdiskriminim, parandalim i ngacmimit dhe sjelljeve të papërshtatshme.
- **Integriteti në prokurime & shërbime:** ndalim i favoreve, transparencë, gjurmueshmëri, raportim i parregullsive.
- **Sinjalizimi i brendshëm:** mekanizëm i sigurt, anonimësi, mbrojtje nga represioni; afate dhe mënyrë trajtimi.
- **Zbatimi dhe përgjegjësitë:** detyrat e titullarëve, njësive të integritetit, HR dhe auditit; bashkërendim me ILDKPKI.

6. Zbatueshmëria, masat disiplinore dhe trajnimi

- Shkeljet e Kodit trajtohen sipas **rregullores së brendshme dhe legjislacionit disiplinor**; masat variojnë nga vërejtja deri në masat ligjore përkatëse.

- **Trajnim detyrues** i stafit (onboarding + periodik vjetor) mbi etikën, konfliktin e interesit, dhuratat, sinjalizimin dhe komunikimin publik.
- **Nënshkrimi i Deklaratës së njohjes së Kodit** nga çdo punonjës; ruajtje në dosjen e personelit.

7. Transparenca, raportimi dhe monitorimi

- Publikim i Kodit në faqen zyrtare dhe në sportelet e informacionit;
- **Raportim vjetor** mbi zbatimin (ankesa, sinjalizime, trajnime, shkelje, masa korrigjuese);
- **Rishikim i Kodit** jo më vonë se **3 vjet** nga miratimi ose sa herë kërkohet nga ndryshimet ligjore.

8. Implikimet buxhetore

Zbatimi i Kodit nuk krijon kosto të reja të pambuluara; shpenzimet për **trajnime, publikime dhe monitorim** parashikohen në buxhetet vjetore të drejtorive përkatëse dhe/ose në projekte partnere.

9. Pritshmëritë dhe përfitimet

- **Rritje e integritetit institucional**, besimit publik dhe cilësisë së shërbimeve;
- **Ulja e riskut** të shkeljeve etike/korrupsionit;
- **Standardizim** i sjelljeve dhe proceseve, me gjurmueshmëri më të lartë;
- **Forcim i kulturës së llogaridhënies** dhe komunikimit me qytetarët.

10. Kërkesa për miratim

Në mbështetje të sa më sipër, i **propozohet Këshillit Bashkiak**:

1. **Miratimi** i “Kodit të Sjelljes të Bashkisë Elbasan”;
2. Ngarkimi i administratës për **zbatimin** e tij dhe përgatitjen e akteve nënligjore/udhëzuese shoqëruese;
3. **Raportim vjetor** pranë Këshillit Bashkiak për ecurinë e zbatimit.

<u>Konceptoi:</u>	Koordinatori	L.Haxhiymeri
<u>Pranoi:</u>	Drejtori	T.Sinanaj
<u>Miratoi:</u>	Drejt.Pergj.	Sh.Cullhaj

ZV/KRYETARI

Asim SULA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
Këshilli Bashkiak

Nr. _____ Prot.

Elbasan, më ____ . ____ . 2025

PROJEKT VENDIM

Nr. ____, datë ____ . ____ . 2025

PËR MIRATIMIN E “KODIT TË SJELLJES 2025” TË BASHKISË ELBASAN

Këshilli Bashkiak, në mbledhejn e tij të datës ____ / ____ / 2025, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga administrata e Bashkisë, Drejtoria e Monitorimit, mbi miratimin e Kodit të Sjelljes 2025, mbështetur në:

- Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;
- VKM nr. 873, datë 24.11.2021 “Për miratimin e rregullave të etikës në administratën publike”;
- Kuadrin kombëtar të integritetit dhe etikës në sektorin publik;
- Strategjinë Kombëtare Antikorrupsion 2024–2030;
- Relacionin shoqërues të paraqitur nga Drejtoria e Monitorimit;

Vendosi

- 1- Miratohet “Kodi i Sjelljes 2025” i Bashkisë Elbasan, sipas tekstit bashkëngjitur këtij vendimi, i cili është pjesë përbërëse e tij.
- 2- Ngarkohet Drejtoria e Administratës dhe Burimeve Njerëzore, Koordinator i Integritetit dhe administrata e Bashkisë për:
 - Zbatimin e Kodit sipas dispozitave të tij;
 - Publikimin e Kodit në faqen zyrtare të Bashkisë dhe në sportelet e informacionit;
 - Organizimin e trajnimeve periodike për të gjithë punonjësit e Bashkisë dhe njërive vartëse mbi përmbajtjen dhe zbatimin e Kodit;

- Sigurimin e nënshkrimit të “Deklaratës së njohjes së Kodit” nga çdo punonjës dhe arkivimin e saj në dosjen personale;
- Raportimin vjetor pranë Këshillit Bashkiak mbi ecurinë e zbatimit dhe rekomandimet për përmirësime.

3- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

<u>Konceptoi:</u>	Koordinator	L.Haxhiymeri
<u>Pranoi:</u>	Drejtori M.	T.Sinanaj
<u>Miratoi:</u>	Drejt.Pergj.	Sh.Çullhaj
<u>Pranoi:</u>	Drejt Juridike	A.Hoxha
<u>Konfirmoi:</u>	ZV/Kryetar	A.Sula

Sekretari

Sokol SINANI

Kryetari

Lutfi LALA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
DREJTORIA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
DREJTORIA BUXHET FINANCË

Nr. 4233 Prot.

Elbasan më 28.08 2025

RELACION

**“Mbi akordimin e një fondi nga Bashkia Elbasan për Bashkinë Gramsh, për
përballimin e pasojave të zjarreve të ndodhura në muajin Gusht 2025”**

Gjatë muajit Gusht 2025, Bashkia Gramsh u përball me një situatë emergjente të shkaktuar nga disa vatra zjarri në zona të ndryshme të territorit. Këto zjarre sollën dëmtime të konsiderueshme në disa nga fshatrat e Njësisë Administrative Skënderbegas, duke cënuar drejtpërdrejt pronën dhe jetën e qytetarëve.

Strukturat zjarrfikëse të Bashkisë Gramsh, së bashku me ndihmën e forcave të tjera, u angazhuan maksimalisht për vënien nën kontroll të situatës, por kostoja financiare dhe logjistike e përballimit të saj ka qenë tepër e lartë për kapacitetet e një bashkie me buxhet të kufizuar si Gramshi.

Në zbatim të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 9, 54, ligjit nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile”, neni 7, i cili përcakton parimin e subsidiaritetit dhe detyrimin e bashkive për të ndihmuar njëra-tjetrën në rastet kur kapacitetet vendore nuk janë të mjaftueshme për përballimin e emergjencave, ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 807, datë 28.12.2023, “Për miratimin e Planit Kombëtar për Emergjencat Civile”, i cili përcakton koordinimin ndërmjet strukturave vendore dhe qendrore në përballimin e emergjencave. Në frymën e solidaritetit ndërmjet njësisë të vetëqeverisjes vendore, si dhe duke pasur parasysh marrëdhëniet e ngushta territoriale dhe institucionale ndërmjet Bashkisë Elbasan dhe Bashkisë Gramsh duke qenë edhe kufitare në territor ka vlerësuar të nevojshme dhe të domosdoshme të akordojë një fond ndihme financiare për Bashkinë Gramsh.

Ky fond ka për qëllim mbështetjen e menjëhershme të Bashkisë Gramsh për të përballuar kostot e dëmeve që kanë ardhur si pasojë e kësaj fatkeqësie; lehtësimin e barrës financiare që ka shkaktuar emergjenca; mundësimin e rikuperimit të një pjese të dëmeve të shkaktuara në territorin e saj; forcimin e bashkëpunimit ndërbashkiak dhe frymës së ndihmës reciproke për përballimin e fatkeqësive natyrore

Duke u mbështetur në sa më sipër, i propozojmë Këshillit Bashkiak Elbasan të miratojë akordimin e një fondi ndihme financiare në vlerën 3,000,000 lekë nga fondi rezervë i Bashkisë Elbasan, i cili do t'i transferohet Bashkisë Gramsh.

Ky fond do të përdoret posaçërisht për menaxhimin e pasojave të zjarreve të ndodhura në muajin gusht 2025, si dhe për rikuperimin e dëmeve të shkaktuara.

Duke Ju falenderuar,

Konceptoi: Përgj sek. Buxh E. Beluli
Miratoi: Dr. Buxh. Fin. A. Merkja
Konfirmoi: Dr. i Përgj. S. Mehmeti



KRYETARI
Gledian Llatja

Me Urdhër e Porosi
ZV/KRYETARI
Klaudia Krasnika





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Adresa: Bashkia Elbasan, Rr. "Q.Stafa", Tel. +355 54 400152, e-mail bashkiaeelbasan@elbasani.gov.al web:www.elbasani.gov.al

Nr. _____ Prot.

Elbasan më, _____.2025

PROJEKT VENDIM

Nr. _____ Datë _____.2025

"Mbi akordimin e një fondi nga Bashkia Elbasan për Bashkinë Gramsh, për përballimin e pasojave të zjarreve të ndodhura në muajin Gusht 2025"

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" nenet 8, 9, 54 të tij; ligjit 45/2019 "Për mbrojtjen civile" neni 7 të tij; si edhe pasi shqyrtoi relacionin dhe dokumentacionin e paraqitur nga Drejtoria e Buxhet Financës dhe Drejtoria e Mbrojtjes Civile

KËSHILLI BASHKIAK
VENDOSI

1. Të miratojë përdorimin e fondit rezervë në masën 3,000,000 lekë duke ia akorduar Bashkisë Gramsh si ndihmë për përballimin e pasojave të shkaktuara nga zjarret e rëna në fshatrat e Njësisë Administrative Skëndërbegas.
2. Burimi i financimit do të jetë buxheti i Bashkisë Elbasan miratuar me VKB nr. 138 datë 26.12.2024, "Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Elbasan për vitin 2025, si dhe Miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm përfundimtar për periudhën 2025-2027".
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Buxhet Financës.

Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore").

SEKRETARI I KËSHILLIT BASHKIAK

KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK

Sokol Sinani

Lutfi Lala

Drejtori MC

Dr. Buxhet Financë

Dr. Juridike

Zv/Kryetari

N. Sinani

A. Merkja

A. Hoxha

K.Krasnika



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
DREJTORIA E PERGJITHSHME E KULTURES DHE SPORTIT

Nr. 4234 Prot.

Elbasan, më 28.8.2025

RELACION

“Mbi shpronësimin e hapësirave private më konkretisht holli qëndrorë i Teatrit “Skampa” nga bashkëpronarët e pasurisë ose të tretë të cilëve u përket pasuria “

KËSHILLIT BASHKIAK

Të nderuar Këshilltarë,

Siç jeni në dijeni, godina e teatrit “Skampa” është në bashkëpronësi të Bashkisë dhe pronarëve privatë, dhe për të cilën me vendimin tuaj nr 89 datë 29.07.2025, është vendosur miratimi i shpronësimit të pjesës së bashkëpronarëve privatë Duke qenë se sipas vendimit nr 748 datë 2.06.1998 të gjykatës së rrethit gjyqësor Elbasan Bashkia detyrohej që tu paguante bashkëpronarëve qira mujore në masën 2166 lekë në muaj për truallin dhe 746,5 USD në muaj për objektin, këshilli bashkiak ka miratuar që bashkëpronarët trashëgimtarë të të ndjerit Xhavit Biçaku, të përdorin hollin e teatrit, duke hequr dorë nga pagesa e sipërcituar.

Vendimi i mësipërm i gjykatës, më pas është prishur nga gjykata e lartë dhe me vendim nr 242 datë 17.02.2005, gjykata e rrethit gjyqësor Elbasan, ka arsyetuar që detyrimi për pjesën e bashkëpronarëve është 108,468 lekë në muaj, duke vendosur dhe detyrimin e Bashkisë ndaj bashkëpronarëve, vendim i cili është lënë në fuqi nga gjykata e Apelit dhe Gjykata e Lartë.

Aktualisht përdorimi i këtij ambjenti nga bashkëpronarët, ka sjellë vështirësi në funksionimin normal të aktivitetit të teatrit, si dhe në sigurinë e tij siç rezulton nga akt-kontrolli i shërbimit zjarrfikës i datës 26.03.2025.

Për sa më sipër, Drejtoria e Artit dhe Kulturës pranë Drejtorisë Përgjithshme Kultures dhe Sportit pranë Bashkisë, kërkon që të lirohen ambjentet e hollit të teatrit dhe të hiqn nga përdorimi i bashkëpronarëve, dhe sipas projekteve tona të organizohet në këtë ambjent një formë muzeu i teatrit “Skampa” dhe bashkëpronarëve t’u paguhet vlera për përdorimin e godinës.

Lirimi i kesaj hapesire do te sillte akses te plote ne te gjithë godinen e Teatrit “ Skampa ” dhe do te permirsonte infrakstrukturen e saj.

Mbeshtetur ne ligjin nr.139/2015 “Per veteqeverisjen vendore ”, i ndryshuar, kërkojmë miratimin e këtij propozimi.

Ju faleminderit!

Konceptoi :


Spec/Jurist : E.Koka



Pergj Sek Juridik Administrativ : L.Saliu



Dr. Arti dhe Kultura : K.Kapaj



Dr. Pergjithshem : A.Kovaçi



ZV/KRYETARI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. _____ Prot.

Elbasan, më _____.____.2025

Projekt Vendim

Nr _____ Datë ____ / ____ /2025

Këshilli Bashkiak, pasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë së Përgjithshme të Kulturës dhe Sportit, për lirim të ambjenteve të hollit të teatrit “Skampa” bazuar në ligjin 139/2015 “Për vetqeverisjen vendore”

Vendosi

- 1- Ambjentet e hollit të teatrit “Skampa” të lirohen dhe përdoren në funksion të aktivitetit të vetë teatrit.
- 2- Bashkia të njoftojë bashkëpronarët dhe të marrë masat për shpërblimin e tyre për përdorimin e godinës sipas vendimit nr 242 datë 17.02.2005 të gjykatës së rrethit gjyqësor Elbasan
- 3- Vendimet e këshillit bashkiak nr 45 datë 25.04.2002 dhe nr 24 datë 24.06.2002, shfuqizohen
- 4- Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Sek. K. Bashkiak
Sokol Sinanaj

Kryetari
Lutfi Lala

Dr. Arti dhe Kultura : K.Kapaj
Dr. Përgjithshëm : A.Kovaçi
Dr Juridike A. Hoxha
Dr Pronave dhe Strehimit A. Suli
Zv/Kryetare K. Krasnika



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E KUJDESIT SOCIAL, ARSIMIT, RINISË
DHE SPORTIT
DREJTORIA E ARSIMIT, SHËNDETËSISË, RINISË, SPORTIT,
MIGRACIONIT DHE DIASPORËS

Nr. 3955 Prot.

Elbasan, më 05.08. 2025

RELACION

PËR MIRATIMIN E “PLANI VENDOR I ARSIMIT PARAUNIVERSITAR,
NË BASHKINË ELBASAN”

Bashkia Elbasan, një ndër bashkitë më të mëdha dhe më të rëndësishme në vend, ka një traditë të gjatë në fushën e arsimit dhe kulturës. Elbasani njihet historikisht si qyteti i Normalës së parë shqiptare, dhe ruan ende një rol qendror në zhvillimin arsimor të rajonit. Në kontekstin e reformave të decentralizimit dhe rritjes së kompetencave të pushtetit vendor, arsimi parauniversitar është bërë një ndër shtyllat kryesore të përgjegjësi të bashkisë, duke përfshirë jo vetëm infrastrukturën dhe shërbimet mbështetëse, por edhe politikat për akses të barabartë, gjithëpërfshirje dhe cilësi. Nisur nga kjo përgjegjësi, Bashkia Elbasan ka ndërmarrë hartimin e **Planit Vendor të Arsimit për periudhën 2025–2028**, si një instrument i rëndësishëm për drejtimin strategjik të zhvillimit arsimor në nivel lokal.

Në përputhje me ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe ligjin nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, bashkitë kanë kompetenca të rëndësishme në ofrimin e shërbimeve mbështetëse për institucionet arsimore. Korniza ligjore e decentralizimit, nxit një bashkëpunim më të ngushtë ndërmjet pushtetit vendor dhe institucioneve arsimore, për të garantuar shërbime efikase dhe të qëndrueshme.

Plani Vendor i Arsimit Parauniversitar dhe hartimi i politikave zhvilluese e strategjike që priten të ndiqen dhe të zbatohen, janë në përputhje me prioritetet kryesore të Strategjisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar 2021-2026 dhe rekomandimet e qeverisë shqiptare për agjendën e integrimit në BE. Ai mbështetet mbi një proces gjithëpërfshirës dhe dhe ndërveprues ku janë angazhuar specialistë të fushës, institucione vendore, përfaqësues të shkollave, komunitetit dhe aktorë të tjerë.

Procesi i planifikimit ka kaluar në disa faza:

- Ngritja e grupit të punës dhe zhvillimi i konsultimeve paraprake;
- Mbledhja dhe analizimi i të dhënave për të identifikuar nevojat dhe sfidat;
- Hartimi i draftit paraprak të dokumentit;
- Konsultimi publik dhe miratimi përfundimtar në Këshillin Bashkiak.

Ky dokument është hartuar me qëllim të përcaktimit të objektivave dhe prioriteteve të Bashkisë Elbasan në fushën e arsimit për katërvjeçarin në vijim, si dhe për të garantuar një planifikim më efektiv dhe gjithëpërfshirës.

Vizioni i Bashkisë Elbasan siguron parimet e barazisë dhe diversitetit, që mundëson formim cilësor të fëmijëve dhe nxënësve në edukim përmes zgjerimit të rrezes së këtij shërbimi në qytet, duke kontribuar të arrijë kushte më të mira për mirërritjen dhe mirëqenien e tyre, mundësi integrimi në tregun e punës dhe mundëson forcimin e karakterit demokratik e përgatitjen e tyre si përfaqësues të denjë në kuadër të integrimit në Bashkimin Europian.

Qëllimi i Planit Vendor të Arsimit Parauniversitar është:

“Garantimi i një shërbimi arsimor cilësor, gjithëpërfshirës dhe i barabartë për të gjithë fëmijët dhe nxënësit, përmes sigurimit të kushteve të përshtatshme infrastrukturore dhe kapaciteteve menaxhuese të institucioneve arsimore, ngritjes së mekanizmave funksionale për cilësinë, transparencën dhe llogaridhënien, si dhe nxitjes së zhvillimit social e kulturor të nxënësve përmes mbështetjes me veprimtari”

Në kuadër të hartimit dhe zbatimit të një plani efektiv për arsimin parauniversitar në nivel bashkiak, është thelbësore të identifikohen prioritetet strategjike, të cilat shërbejnë si boshti udhëheqës për ndërhyrjet e nevojshme. Këto prioritete mbështeten në analiza të nevojave arsimore dhe synojnë përmirësimin e cilësisë, barazisë dhe qasjes në arsim.

Për realizimin e këtij qëllimi, bashkia Elbasan vendos si prioritete:

1. Investimi dhe përmirësimi në infrastrukturë, rritja e cilësisë së shërbimit arsimor, zhvillimi profesional i mësuesve dhe fuqizimi i bashkëpunimit me komunitetin, në funksion të edukimit për zhvillim të qëndrueshëm dhe qytetari aktive.
2. Hartimi i politikave dhe planifikimeve strategjike lokale në funksion të përmirësimit të shërbimit arsimor në zonat e juridiksionit të bashkisë Elbasan si dhe nxitja e përfshirjes dhe barazisë në arsim.
3. Bashkëpunim ndërinstitucional, pjesëmarrje e komunitetit dhe përthithje e përvojave më të mira, lidhur me aspekte të menaxhimit efektiv të sistemit arsimor parauniversitar në të gjitha nivelet e tij.

Plani mbulon periudhën 2025–2028 dhe përfshin:

- Vlerësimin e situatës aktuale të infrastrukturës, burimeve njerëzore dhe përfshirjes në arsim;
- Prioritetet kryesore si: përmirësimi i infrastrukturës shkollore dhe parashkollore, rritja e aksesit në arsim për grupet në nevojë, forcimi i kapaciteteve profesionale të stafit, dixhitalizimi dhe garantimi i mjediseve të sigurta e mbështetëse për fëmijët;
- Masat konkrete që do të ndërmerren për zbatimin e objektivave;
- Kostot e pritshme dhe burimet e financimit, duke përfshirë buxhetin vendor, burime nga qeveria qendrore, si dhe partneritete me organizata dhe donatorë.

Përmes miratimit të këtij Plani, Bashkia Elbasan synon:

- Të forcojë rolin e saj në garantimin e një shërbimi arsimor të cilësisë së lartë;
- Të planifikojë në mënyrë të qëndrueshme dhe të bazuar në nevoja reale investimet në arsim;
- Të promovojë një model gjithëpërfshirës dhe të ndjeshëm ndaj grupeve të marginalizuara;
- Të përmirësojë transparencën dhe llogaridhënien në menaxhimin e shërbimeve arsimore.

Duke pasur parasysh rëndësinë e këtij dokumenti si një udhërrëfyes për zhvillimin e qëndrueshëm të arsimit në nivel vendor, si dhe rolin thelbësor që ka Këshilli Bashkiak në orientimin dhe mbështetjen e këtyre politikave, propozohet miratimi i Planit Vendor të Arsimit 2025–2028 për Bashkinë Elbasan. Ky plan përfaqëson një përpjekje të përbashkët për të ndërtuar një sistem arsimor më cilësor, më gjithëpërfshirës dhe më të afërt me nevojat e komunitetit tonë.

Konceptoi: Përgjegjës, E.Stafa

Pranoi: Drejtori i DASHRSMD, K.Lala

Miratoi: Drejtori i përgjithshëm, DPKSARS, D.Rroseni

KRYETARI

Gledian Llatja

NË MUNGESË DHE ME URDHËR

ZV/KRYETARI

Armand Shehu





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. _____ Prot.

Elbasan, më _____. 2025

PROJEKT VENDIM

Nr. _____, datë _____. 2025

PËR MIRATIMIN E "PLANI VENDOR I ARSIMIT PARAUNIVERSITAR
2025 – 2028, BASHKIA ELBASAN"

Këshilli Bashkiak, në mbledhje të datës _____. 2025, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga administrata e Bashkisë, Drejtoria e Arsimit, Shëndetësisë, Rinisë, Sportit, Migracionit dhe Diasporës, mbi miratimin e Planit Vendor të Arsimit Parauniversitar, mbështetur në Nenin 32 të Ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar; Ligjin nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; Udhëzimin e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit për hartimin e planeve vendore të arsimit parauniversitar; Strategjinë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar 2021–2026 dhe Relacionin shpjegues të Bashkisë Elbasan mbi Planin Vendor të Arsimit Parauniversitar 2025–2028,

VENDOSI:

- 1- Miratimin e **Plani Vendor i Arsimit Parauniversitar 2025–2028** i Bashkisë Elbasan, si dokument strategjik që përcakton objektivat, prioritetet dhe masat për zhvillimin e arsimit parauniversitar në territorin e bashkisë.
- 2- Ky plan është pjesë integrale e dokumenteve të zhvillimit afatmesëm të Bashkisë dhe shërben si udhërrëfyes për përfshirjen e masave për arsimin në programimin dhe zbatimin e buxhetit vendor.
- 3- Ngarkohet Drejtoria e Arsimit, Shëndetësisë, Rinisë, Sportit, Migracionit dhe Diasporës në Bashkinë Elbasan, në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse, Drejtorinë e Financës dhe çdo strukturë tjetër përkatëse, për zbatimin dhe raportimin periodik të Planit.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore".

SEKRETARI
Sokol Sinani

KRYETARI
Lutfi Lala

Konceptoi:

Drejtoria e DASHRMDS

Drejtoria e DPKSAPR,

Drejtoria Juridike:

Drejtoria Buxhet & Financë: A.Merkja

Zv/kryetar:

K.Lala

D.Roseni

A.Hoxha

A.Merkja

A.Shehu